

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6227
E shtunë, 30 janar 2021
çmimi 0.40 €

Kosova dhe Izraeli më 1 shkurt lidhin marrëdhënie diplomatike



FAQE 3

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GJYKATA SUPREME KA VENDOSUR PËR PESË ANKESAT E PARTIVE POLITIKE

FAQE 4-5



SUPREMJA NUK E CERTIFIKON KURTIN PËR ZGJEDHJET E 14 SHKURTIT

Gjykata Supreme ka pranuar pjesërisht ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) lidhur me certifikimin e kandidatëve për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Sipas vendimit të Supremes, Liburn Aliu dhe Labinotë Demi-Murtezi duhet të përfshihen në listën e kandidatëve të LV-së, por jo edhe Albin Kurti, Albulena Haxhiu dhe Bajram Mavriqi. Gjithashtu, Supremja ka urdhëruar KQZ-në që Shemsedin Dreshaj të përfshihet në listën e AAK-së. Gjykata Supreme ka refuzuar në tërësi ankesën e Nismës Socialdemokrate dhe dy partive të tjera të minoriteteve

OPINION

KUR DEBATET POLITIKE SYNOJNË T'I DEVALVOJNË PERSONALITETET DHE HISTORINË F. 8

Shkruan: Ramiz
LLADROVCI



VIZITË SKANDALOZE E MINISTRIT TË JASHTËM TË SERBISË NË SOFJE F. 8

Dr. Anton
PANÇEV



AKTUALE



PRISHET KOALICIONI LDK - LV NË VUSHTRRI F. 10

AFËR 1 MILION EURO PËR INFRASTRUKTURËN E KLINËS F. 6

EKONOMI

ANASHKALIMI I SEKTORIT TË PRODHIMIT NUK LEJON ZHVILLIMIN EKONOMIK NË VEND F. 9

OAK-U KËRKON ELIMINIMIN E BARRIERAVE TË EKSPORTIT ME SHQIPËRINË F. 9

TRI RASTE TË INFEKTIMIT ME VARIANTIN BRITANIK TË COVIDIT NË KOSOVË

Në Kosovë janë paraqitur tri raste të variantit britanik të Covid-19-shit. Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se situata me Covid në vendin tonë është e qetë. Ndërsa Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë pesë persona si pasojë e infektimit me Covid-19. Po ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur 342 raste të reja dhe janë shëruar 235 persona



PAS DEKLARATAVE NXITËSE TË VUÇIQIT, HOTI U SHKRUAN LETËR VENDEVE ANËTARE TË QUINTIT

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kina: Pavarësia e Tajvanit nënkupton luftë

PEKIN, 29 JANAR - Kina ka paralajmëruar se përpjekjet e Tajvanit për të kërkuar pavarësi "nënkupton luftë". Paralajmërimi vjen disa ditë pasi Kina ka rritur aktivitetet ushtarake, duke fluturuar me avionë luftarakë pranë ishullit. Ky paralajmërim vjen pasi presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden, ka rikonfirmuar angazhimin ndaj Tajvanit. ShBA-ja ka

theksuar se paralajmërimi i fundit i Kinës "është për keqardhje". Kina e sheh Tajvanin si provincë të shkëputur, por Tajvani e sheh veten si shtet sovran. "U themi seriozisht atyre forcave të pavarësisë së Tajvanit: ata që luajnë me zjarr, do të digjen vetë, dhe pavarësia e Tajvanit do të thotë luftë", ka thënë zëdhënësi i Ministrisë kineze të Mbrojtjes, Wu Qian. Wu, po ashtu, ka

mbrojtur aktivitetet e fundit ushtarake të Kinës, duke thënë se ato ishin "veprime të nevojshme për ta adresuar situatën aktuale të sigurisë në ngushticën e Tajvanit dhe për ta mbrojtur sovranitetin dhe sigurinë kombëtare". Ndërsa zëdhënësi i Pentagonit, John Kirby, ka thënë se "nuk sheh arsye se përse tensionet mbi Tajvanin duhet të çojnë në diçka si konfrontimi".



Ekipi i OBSH-së viziton një spital të Vuhanit

VUHAN, 29 JANAR - Një ekip i ekspertëve ndërkombëtarë është takuar me shkencëtarët kinezë dhe ka vizituar një spital në Vuhan të Kinës në të cilin janë trajtuar pacientët e parë pas zbulimit të Covid-19.

Ekipi i caktuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) është duke hetuar origjinën e koronavirusit. Ekspertët kanë planifikuar vizita në laboratorë, tregje dhe spitale të Vuhanit. Misioni hulumtues është përbërur me vëzhgues të nisjes së punës, pasi Kina i kishte kërkuar OBSH-së më shumë kohë për ta

lejuar vizitën.

Madje zyrtarët kinezë dhe mediat shtetërore janë përpjekur të hedhin dyshime nëse virusi e ka origjinën në Kinë. Më 28 janar, familjarët e viktimave që vdiqën nga koronavirusi në Vuhan të Kinës, thanë se autoritetet kineze kanë fshirë një grup në mediat sociale që ata kanë pasur dhe po u bëjnë presion që të mos flasin.

Dhjetëra familjarë të viktimave janë bashkuar në platformat online, për të kërkuar përgjegjësi nga zyrtarët e Vuhanit, të cilët ata i fajësojnë



se nuk e kanë trajtuar siç duhet situatën, kur në fund të vitit 2020 u regjistruan rastet e para me koronavirusin e ri, shkruan "AFP".

Koronavirusi i ri besohet se ka origjinën nga lakuriqët dhe fillimisht është përhapur në një treg në Vuhan ku shtazët e egra shiten si ushqim. Por, për këtë teori dihet shumë pak. Një tjetër teori, të cilën e ka përmendur vazhdimisht edhe ish-presidenti amerikan Donald Trump, është që virusi ka dalë nga një laborator në Vuhan, ku shkencëtarët ishin duke studiuar koronavirusët.

Pesë të vdekur nga zjarri në një spital në Bukuresht



BUKURESHT, 29 JANAR - Zyrtarët rumunë kanë bërë me dije se së paku pesë persona kanë vdekur pas shpërthimit të zjarrit në një spital në Bukuresht, ku po trajtoheshin pacientë me koronavirus. Sekretari i Ministrisë së Brendshme, Raed Arafat, ka thënë se tre pacientë janë gjetur të vdekur në spitalin Matei Bals, ndërsa i katërti ka vdekur pavarësisht prej përpjekjeve për ta shpëtuar. Tripi i viktimës së pestë është

gjetur më vonë në një nga banjat, ka konfirmuar ministri i Brendshëm rumun, Lucian Bode. Sipas tij, 60 njerëz është transferuar në ndërtesa të tjera të Institutit Matei Bals dhe 44 të tjerë në spitale të tjera të Bukureshtit. Zjarri, i cili është shuar, ka shpërthyer në katin e parë, rreth orës 5 të mëngjesit. Sipas zjarrfikësve, në ndërtesë kanë qenë rreth 200 njerëz në kohën e zjarrit. Shkaku i incidentit nuk dihet ende. Ministria e Shëndetësisë ka

sugjeruar se ai mund të jetë shkaktuar nga një qark i shkurtër elektrik. Autoritetet kanë nisur tashmë hetimet. Rumania, njëri nga vendet më të varfra në Bashkimin Evropian, po përpiqet ta menaxhojë pandeminë e koronavirusit me një sistem të dobët shëndetësor dhe mungesa stafi. Ky vend me 19 milionë banorë ka raportuar mbi 721 000 raste me koronavirus dhe mbi 18 100 viktime.

Ukraina ndalon përdorimin e vaksinës ruse kundër Covidit

KIEV, 29 JANAR - Parlamenti i Ukrainës ka miratuar të premtën një ligj që synon ta përshpejtojë aprovimin e vaksinave kundër koronavirusit, gjithashtu ndalon aprovimin e vaksinave të prodhuara në Rusi. Qeveria e Ukrainës ka bërë me dije se pret të marrë 100 mijë deri në 200 mijë doza të vaksinave të bëra nga kompanitë "Pfizer" dhe "BioNTech" përmes skemës së njohur si "COVAX". "COVAX"-i, një nismë e Organizatës Botërore të

Shëndetësisë, që synon shpërndarjen e vaksinave edhe në vende më të varfra, pritet t'i nisë operacionet në shkurt. Në Ukrainë nuk është aprovuar ende asnjë vaksinë, por autoritetet vazhdimisht kanë thënë se Kievi nuk do të miratojë ose përdorë vaksina nga Rusia - vend me të cilin lidhjet e Ukrainës janë të tendosura. "Biolik", kompani farmaceutike ukrainase, e mbështetur nga Viktor Medvedchuk, një figurë e shquar e opozitës me prirje

pro-ruse, ka thënë në fillim të këtij muaji, se ka aplikuar për miratimin e shtetit, për prodhimin e vaksinës ruse kundër koronavirusit "Sputnik V". "Askush nuk do ta regjistrojë vaksinën ruse në vend", ka thënë ministri ukrainas i Shëndetësisë, Maksym Stepanov. Marrëdhëniet midis dy vendeve janë të tensionuara prejse Rusia ka aneksuar gadishullin ukrainas të Krimesë në vitin 2014 dhe është përfshirë në një konflikt



të armatosur midis separatistëve dhe forcave pro-qeveritare në lindje të

Ukrainës. Mbi 14 000 njerëz kanë vdekur në këtë konflikt që vazhdon ende.

Pas deklaratave nxitëse të Vuçiqit, Hoti u shkruan letër vendeve anëtare të Quintit

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Avdullah Hoti, të premtën u ka dërguar një letër ambasadorëve të vendeve anëtare të Quintit dhe ambasadorit të BE-së në Kosovë, përmes së cilës ka kërkuar reagimin e tyre, pas deklaratave nxitëse të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili ka thënë se do t'i ngrehë kapacitetet ushtarake, me pretekst zhvillimet në Kosovë. Hoti ka thënë se deklaratat e tilla nuk i shërbejnë paqes dhe stabilitetit në rajon, aq më pak arritjes së marrëveshjes përfundimtare dhe njohjes reciproke



**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 JANAR - Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, u ka dërguar një letër ambasadorëve të vendeve anëtare të Quintit dhe ambasadorit të BE-së në Kosovë, përmes së cilës ka kërkuar reagimin e tyre, pas deklaratave nxitëse të presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili ka thënë se do t'i ngrehë kapacitetet ushtarake, me pretekst zhvillimet në Kosovë.

Hoti ka thënë se deklaratat e tilla nuk i shërbejnë paqes dhe stabilitetit në rajon, aq më pak arritjes së marrëveshjes përfundimtare dhe njohjes reciproke. "Kosova mbetet e përkushtuar në rrugën e saj drejt

integritimit në NATO dhe thellimit të bashkëpunimit me partnerët strategjikë ndërkombëtarë, ShBA-së dhe vendeve mike të BE-së. Deklarata e presidentit të Serbisë, Vuçiq, për ngritjen e kapaciteteve ushtarake, me pretekst zhvillimet në Kosovë, nuk i shërben paqes dhe stabilitetit në rajon, aq më pak arritjes së marrëveshjes përfundimtare dhe njohjes reciproke", ka thënë Hoti.

Po ashtu, Hoti ka reaguar edhe rreth presionit dhe kërcënimeve të Listës Serbe, ndaj pakicave joserbe në Kosovë. "Këto deklaratat si dhe presioni dhe frikësimi i pakicave joserbe kanë për qëllim të ndërhyjnë në zgjedhjet parlamentare të Kosovës dhe t'i prishin proceset

demokratike në vendin tonë. Këto sjellje janë të papranueshme. Ne kërkojmë nga ju që t'i merrni të gjitha masat e nevojshme ndaj kësaj qasje të rrezikshme dhe ta bëni të qartë se ndërhyrja në proceset politike në Kosovë nuk mund të kalojë pa pasoja, për ata që janë të përfshirë", ka deklaruar kryeministri Hoti.

Ai ka shprehur përkushtimin institucional të Kosovës për të organizuar zgjedhje të lira dhe të ndershme, duke mundësuar pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve me të drejtë vote, si

garantuesin më të mirë për shprehjen e vullnetit të lirë të njerëzve dhe krijimin e institucioneve demokratike.

Ndaj deklaratës së Vuçiqit ka reaguar edhe ish-shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Daut Haradinaj, i cili ka thënë se gjuha e urrejtjes dhe kërcënimit e Vuçiqit në llogari të Kosovës, nuk i ndihmojnë aspak stabilitetit rajonal. "Ngritja e kapaciteteve ushtarake në gjendje gatishmërie, me pretekst se 'ndihet i kërcënuar nga situata në Kosovë', është gjuhë e rrezikshme nga e cila ka pësuar i tërë rajonit,

ndërkaq Serbisë i ka sjellë humbje të luftërave dhe izolim. Kosova ka një forcë mbrojtëse moderne e cila po merr pjesë në misione paqeruajtëse, me synim anëtarësimin sa më të shpejtë në NATO. Uroj që edhe Serbia sa më parë t'i bashkohet aleancës perëndimore, duke llogaritur paqe, stabilitet, bashkëpunim dhe fqinjësi të mirë me të gjithë fqinjët e saj. Ne jemi më shumë se të vendosur në rrugën tonë drejt Perëndimit. Kosova është shtet i pavarur dhe nuk ka kthim mbrapa", ka deklaruar Daut Haradinaj.

Kosova dhe Izraeli më 1 shkurt lidhin marrëdhënie diplomatike

PRISHTINË, 29 JANAR (ER) - Më 1 shkurt Kosova dhe Izraeli do ta firmosin vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, ka njoftuar Ministria e Jashtme dhe e Diasporës në Kosovë. Firmosja zyrtare e lidhjes së marrëdhënieve diplomatike do të bëhet nga ministrja në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës, Meliza Haradinaj-Stublla, dhe ministri i Punëve të Jashtme të Izraelit, Gabriel Ashkenazi. "Republika e Kosovës po hyn në një etapë të re historike me shtetin e Izraelit. Shtetësia dhe subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës po konsolidohet fuqishëm. Ky moment tejet i rëndësishëm për ne është përjetësim i miqësisë së gjatë mes popujve tanë, që tani po kurorëzohet me lidhjen e marrëdhënieve diplomatike", citohet të ketë thënë shefja e diplomacisë së Kosovës, duke shtuar se Kosova është përjetësisht mirënjohëse ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Më 4 shtator 2020 Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar në



Shtetëpinë e Bardhë në Uashington dy dokumente për normalizimin e raporteve ekonomike, në prani të ish-presidentit amerikan Donald

Trump. Ato u ndërmjetësuan nga i dërguari i atëhershëm i Trumpit për dialogun, Richard Grenell. Me marrëveshjen e nënshkruar në

Uashington, Kosova është zotuar se do të vendosë marrëdhënie diplomatike me Izraelin dhe se do ta hapë misionin e saj diplomatik

në Jerusalem, ndërsa Serbia është zotuar se do ta zhvendosë ambasadën e saj ekzistuese në Izrael nga Tel Avivi në Jerusalem.



GJYKATA SUPREME KA VENDOSUR PËR PESË ANKESAT E PARTIVE POLITIKE

Supremja nuk e certifikon Kurtin për zgjedhjet e 14 shkurtit

Gjykata Supreme ka pranuar pjesërisht ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) lidhur me certifikimin e kandidatëve për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit. Sipas vendimit të Supremes, Liburn Aliu dhe Labinotë Demi-Murtezi duhet të përfshihen në listën e kandidatëve të LV-së, por jo edhe Albin Kurti, Albulena Haxhiu dhe Bajram Mavriqi. Gjithashtu, Supremja ka urdhëruar KQZ-në që Shemsedin Dreshaj të përfshihet në listën e AAK-së. Gjykata Supreme ka refuzuar në tërësi ankesën e Nismës Socialdemokrate dhe dy partive të tjera të minoriteteve

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

Prishtinë, 29 janar - Gjykata Supreme ka vendosur për ankesat e partive politike lidhur me certifikimin e kandidatëve për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit, duke pranuar pjesërisht dy ankesa dhe refuzuar tri të tjera. Supremja ka bërë me dije se ka pranuar pjesërisht ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje që Liburn Aliu dhe Labinotë Demi-Murtezi të hyjnë në listën e kandidatëve të LV-së, pasi Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia ka bërë vlerësim të gabuar të dënimit trevjeçar. "Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar

se afati trevjeçar duhet të llogaritet duke iu referuar datës së aktgjykimit penal të formës së prerë për secilin kandidat veç e veç e deri në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve, që në këtë rast është data 14 shkurt 2021", është thënë në vendimin e Supremes. Kjo nënkupton që Albin Kurti, Albulena Haxhiu dhe Bajram Mavriqi nuk do të garojnë në këto zgjedhje. Supremja në mënyrë të pjesshme ka miratuar edhe ankesën e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) duke kërkuar që kandidatit Shemsedin Dreshaj t'i mundësohet përfshirja në listën e kësaj partie. "Ankesa e ushtruar nga subjekti politik Aleanca për

Ardhmërinë e Kosovës (AAK), është pranuar pjesërisht e themeltë nga kolegji i Gjykatës Supreme. Është ndryshuar pjesërisht vendimi i PZAP-së, Anr. 15/2021, dhe vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 240-2021, lidhur me certifikimin e kandidatëve për deputetë, duke urdhëruar KQZ-në që kandidatin për deputet Shemsedin Dreshaj, ta përfshijë në listën e kandidatëve për deputetë. Ndërkaq, është refuzuar pjesërisht e pabazuar ankesa e AAK-së, duke vërtetuar pjesën tjetër të vendimit të PZAP-së", është thënë në vendim. Sipas këtij vendimi, Gani

174 MIJË APLIKUES KANË APLIKUAR PËRMES EMAILI-T PËR ZGJEDHJET E 14 SHKURTIT

Kryeshefi ekzekutiv i sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Burim Ahmetaj, ka thënë se mbi 174 mijë aplikues kanë aplikuar përmes emaili-t për zgjedhjet e 14 shkurtit. "Operacioni i hapjes së emailave është përfunduar dhe tash jemi në fazën e procesimit të dhënave. Mbi 174 mijë aplikues që kanë aplikuar përmes e-mail deri më tani", ka thënë Ahmetaj në mbledhjen e sotme të KQZ-së.

Ndërkaq kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka thënë se partitë politike po e përdorin këtë institucion për t'i shpalosur platformat politike. Daka ka kërkuar nga anëtarët e partive politike të flasin me radhë dhe ka apeluar që shkresat kur ia dërgojnë t'i kontrollojnë. "Unë barti çdo përgjegjësi për të gjitha shkresat që i nënshkruaj", ka thënë Daka. Me këtë deklaratë nuk është pajtuar anëtari i LV-së, Sami Kurteshi, i cili ka theksuar se kanë të drejtë t'i bartin kërkesat e partive në KQZ. "Nuk kanë kaluar listat dhe kush ka propozuar që të bëhet një selektim, propozojmë që listat të mos miratohen dhe këtë vendim nuk e ka marrë KQZ-ja", ka thënë Kurteshi.

për Ankesa dhe Parashtrësë, i cili brenda afateve ligjore i kishte dhënë të drejtë KQZ-së. Më 3 janar 2018, deputetët e atëhershëm të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Faton Topalli dhe Donika Kadaj-Bujupi, janë dënuar me kusht për hedhjen e gazit lotsjellës në ambientet e Kuvendit të Kosovës, ndërsa në shtator të po atij viti Gjykata e Apelit i ka vërtetuar dënimet e shqiptuara nga gjykata e shkallës së parë.

Dreshaj, Rrahim Ajeti dhe Shqipe Kastrati nuk mund të certifikohen, bazuar në këtë vendim. "Edhe në rastin e pranimit të pjesshëm të ankesës së AAK-së, bëhet fjalë për vlerësimin e gabuar të afatit trevjeçar, ndërkohë që duhet referuar datës së aktgjykimit penal të formës së prerë për secilin kandidat veç e veç, e deri në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve, që në këtë rast është data 14 shkurt 2021", është thënë në vendim.

Ndërkaq ankesat e nisura nga Partia e Ashkalinjve për Integrim (PAI), Nova Demokratska Stranka (NDS) dhe Nisma Socialdemokrate, janë konsideruar të pabaza.

Ankesat e këtyre partive politike kanë ardhur pasi më 22 janar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka votuar për të mos certifikuar listat me kandidatë për deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës Socialdemokrate dhe disa parti të komuniteteve joshumicë.

Ky vendim i KQZ-së nxit reagime të shumta të partive politike, pasi vetë Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim kishte rekomanduar që të certifikohen listat zgjedhore të të gjitha partive.

Më pas, partitë politike ishin ankuar në Panelin Zgjedhor

Nagavci: Qeveria 'Kurti 2' është e pashmangshme

Lëvizja Vetëvendosje ka reaguar ndaj vendimit të Gjykatës Supreme, ku kandidatit për kryeministër nga kjo parti, Albin Kurti, nuk i është lejuar kandidimi për deputet në zgjedhjet e 14 shkurtit. Arbërie Nagavci nga LV-ja ka thënë se

qeveria 'Kurti 2' është e pashmangshme dhe e shumëpritur. "Qeveria 'Kurti 2' është realiteti i ri, i pashmangshëm dhe i shumëpritur. E nderuar që në rrugëtimin politik jam e rreshtuar drejt dhe në anën e

duhur. Më 14 shkurt qytetarët do të tregojnë fuqishëm përkrahjen për Albin Kurtin, e kjo do të jetë jo vetëm përgjigjja më e mirë për institucionet e kapura, por dhe fillimi i punës për shtetin e së drejtës", ka shkruar Nagavci në llogarinë e vet në "Facebook".

Vizitë skandaloze e ministrit të Jashtëm të Serbisë në Sofje



Dr. Anton PANÇEV

Më 20 janar ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Nikolla Selaković, realizoi takim me ministren e Jashtme bullgare Ekaterina Zaharieva. Në konferencën për media me gazetarë bullgarë, N. Selaković bëri deklaratë shqetësuese dhe arrogante në lidhje me vlerësimin e të kaluarës shoviniste të Serbisë. Përplasja e parë ishte lidhur me Republikën e Kosovës. Z. Selaković bëri përpjekje për ta sfiduar politikën e Bullgarisë ndaj Kosovës duke thënë se "E kuptojmë qëndrimin e Bullgarisë në lidhje me çështjen e Kosovës dhe të Metohisë, por për ne me rëndësi është zgjidhja të kërkohet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Dëshira jonë është që të rifillojë dialogu dhe të mos bëhen hapa që do ta dëmtonin". Pra, ministri i Jashtëm serb ende mendon se Republika e Kosovës qenka pjesë nga "politika e brendshme serbe" dhe shtete të tjera nuk mund t'i zhvillojnë marrëdhëniet me Kosovën pa pëlqimin e Beogradit!

Duke e pyetur ministrin serb pse Serbia është i vetmi shtet ish-komunist, që ende nuk i ka hapur dosjet e policisë famëkeqe të diktatorit Tito, UDB-a, dhe që ka qenë përgjegjëse edhe për vrasjen e mijëra njerëzve të pafajshëm, Selaković deklaroi: "Nuk jam në dijeni nëse jemi shteti i fundit evropian, që e ka bërë ose nuk e ka bërë këtë gjë. Unë jam burrë shteti, nuk kemi frikë nga asgjë, sepse ka kaluar shumë kohë. Sa më kujtohet, disa prej këtyre arkivave u hapën pjesërisht në ministrinë që e drejtoj tani. Nuk e di çfarë të mirë ka sjellë hapja e këtyre dosjeve". Ai shtoi, gjithashtu, se partitë që janë marrë me këtë çështje e kanë humbur besimin e votuesve, kurse populli i Serbisë kërkon në BE. Ministri i Jashtëm serb deklaroi edhe gjëra të tjera skandaloze, p. sh., se qenka krenar me punën e Aleksandër Vuçiqit si ministër i Informatës i diktatorit Slobodan Millosheviq, që ishte akuzuar për gjenocid dhe krime lufte në Hagë. Ministri serb plotësoi se në vitin 1999 Serbia paska qenë viktimë e agresionit të NATO-s!

Kjo sjellje tepër sfiduese e ministrit të Jashtëm të Serbisë tregon qartë se në Beograd vazhdojnë të mbretërojnë fantazmat shoviniste nga koha e Millosheviqit dhe asnjë ndryshim pozitiv në mendimin e udhëheqësve të Serbisë nuk ka ndodhur. Bashkimi Evropian dhe anëtarët e tij duhet ta ndryshojnë qasjen indiferente dhe negociatat me Serbinë të kushtëzohen edhe me të drejtat e pakicave në Serbi, me hapjen e dosjeve të shërbimeve represive serbe (jugosllave), me zbulimin e elaboratave serbe dhe të mekanizmit gjenocidal kundër bullgarëve, shqiptarëve dhe disa komuniteteve të tjera gjatë shekullit XX.

Kur debatet politike synojnë t'i devalvojnë personalitetet dhe historinë



**Shkruan: Ramiz
LLADROVCI**

Kur debatet politike synojnë t'i devalvojnë personalitetet dhe historinë tashmë të krijuar, është nivel i rëndë i sëmundjes së fallxhorëve.

Është e rëndë të dëgjosh sot kualifikime të sëmura për ta zvogëluar kontributin e atdhetarëve, me një pyetje të thjeshtë: çfarë kontributi ka dhënë filan atdhetari në ilegale? Çfarë arriti me ilegale? Çfarë arriti me qëndrimin në burg? Çfarë arriti me UÇK-në, kur

NATO ishte me aeroplanë? Çfarë arriti në liri? Çfarë bëri për shqiptarët? Asgjë nuk ka arritur, asgjë nuk ka bërë... ky lloj mashtrimi, ky lloj minimizimi i kontributit të atdhetarëve, është neveritës. Për të qenë edhe më keq, këta gojshthurrur, marrin nëpër gojë personalitetin që krijoi histori për popullin shqiptar në Maqedoninë e Veriut, për liderin e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, Ali Ahmetin.

E kuptoj pse sulmohet Ali Ahmeti, sepse ata që janë kundër tij në emisione, vijnë nga çerdhet që e luftuan Ali Ahmetin nga Kosova për 20 vjet. Për 20 vjet jo vetëm se e sulmuan në fushata e media nga Kosova, por edhe duke i dhënë mend për realitetin që ai vetë e kishte ndërtuar, me gjak e djersë.

Nuk çuditim pse sulmohet Ali Ahmeti, sepse është lumë që nuk

njeh brigje sa demagogët e debateve nuk arrijnë ta kuptojnë. Këta demagogë nuk kanë qenë moti në Maqedoninë e Veriut për të parë ndryshimin dhe të arriturat. Jo vetëm praninë në NATO, por edhe barazinë e gjuhëve, praninë në institucione të shqiptarëve apo investimet dhe të arriturat e tjera që për shqiptarët gjatë shekullit XX, ishin të ndaluara, madje të paarritshme. Këtë histori nuk e krijoi Ali Ahmeti as me fjalë as me debate. Këta demagogë që ka kohë po e korruptojnë ambientin dhe duan të krijojnë realitet të ri për ideologun e vet në ardhje edhe në Maqedoninë e Veriut, marrin të drejtën të flasin për ato që nuk i dinë, nuk i njohin dhe nuk duan ta njohin as gjendjen e shqiptarëve dje, as sot e as nesër.

Këta demagogë duhet ta dinë një herë e mirë se dimensionin e Ali

Ahmetit nuk mund ta mbajnë as brigjet e Drinit as Vardarit. Ali Ahmeti nuk u mor me debate, as me shpjegimin e veprimeve se çka është mirë për shqiptarët apo me demagogjinë e librave të lexuar. Ai e krijoi historinë e re të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, duke e bërë faktor dhe kreator të historisë në shtet. Ai e nxori shqiptarin në dimensionin që kurrë më herët nuk e pati atje, jo vetëm si ushtar, por edhe si oficer, si administrator dhe kreator të së ardhmes së vet në ekonomi, arsim, universitet, kulturë, sport e çdo fushë tjetër të jetës. Ai e krijoi realitetin të cilin e jetojnë shqiptarët, por edhe të gjithë qytetarët në Maqedoninë e Veriut.

Prandaj, jo xhepat, por as brigjet e lumenjve nuk e mbajnë dimensionin e Ali Ahmetit. Ai nuk bëri as do të bëjë garë për lexime, as për poza politike, as

për njohje të gjuhëve të huaja, as për Kantin e mendimtarët e tjerë, sepse ai vetë është filozof atdhetarie, lirie e çlirimi.

Qytetari, me votën e lirë ia ka treguar dhe ia tregon vendin secilit, për programin, profilin e liderit, të kaluarën e tij dhe çfarë përfaqëson. Nuk është xhepi vend për oponentin. Lidhja e xhepit me politikën, është kombinim i keq dhe pa shije. Ali Ahmeti në 40 vjetët e fundit i dha rrugë historisë atdhetare e çlirimtare në Kosovë, Luginën e Preshevës dhe Maqedoninë e Veriut. Prandaj, këtë dimension të atdhetarit, veprimtarit e çlirimtarit nuk ka bir nane që i jep dimension, as sot e as nesër. Vendi i tij moti është shënuar dhe i rezervuar në historinë e re të kombit.

Fallxhorë, nëse nuk dini më mirë, mos prodhoni mjerim për opinion!

Sfidë për komunat, arritja e rezultateve konkrete në fushën lokale



PRISHTINË, 29 JANAR (ER) - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka organizuar takim të radhës të Kolegjiumit të Zyrarëve Komunalë për Integritim Evropian, në kuadër të koordinimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të parapara në

funkcion të realizimit të planit të punës. Në funksion të raportimit sa më të mirë të aktiviteteve komunale, kolegjiumi i zyrarëve komunalë për integritim evropian ka diskutuar mbi sfidat e raportit për përmbushjen e obligimeve

të komunave nga agjenda evropiane.

Raporti është shumë i rëndësishëm dhe domethënës mbi zhvillimin e aktiviteteve të komunave, për raportimin e punës dhe arritjeve komunale në fushat specifike me qëllim të

informimit të gjendjes aktuale në segmente të ndryshme të procesit të integritimit evropian në nivel lokal. Me këtë rast, kryesuesja e Kolegjiumit, Ajshe Berveniku, ka theksuar se, pavarësisht që komunat kanë shënuar përparim për

plotësimin e kriterëve, sfida me të cilën ballafaqohen komunat mbetet ekzekutimi në sektorë të ndryshëm dhe arritja e rezultateve konkrete në fushën lokale.

Një ndër temat e trajtuara ishte edhe procesi i raportimit (matrica) të Ministria e Pushtetit Lokal (MPL), në mënyrë që të përcaktohen shumë qartë veprimet vetëm në ato fusha të cilat komunat janë përgjegjëse, me qëllim përmirësimin e prezantimit të arritjeve komunale në procesin e integritimeve evropiane.

Me qëllim të bashkërendimit të punëve midis institucioneve qendrore dhe komunale, veçanërisht për të diskutuar për çështjet që ndërlidhen me procesin e integritimit evropian të Kosovës, anëtarët e kolegjiumit edhe një herë kërkuan shtimin e aktiviteteve me ministritë e linjës përmes bashkëpunimit reciprok dhe angazhimit për zbatimin agjendës evropiane.

Afër 1 milion euro për infrastrukturën e Klinës

PRISHTINË, 29 JANAR (ER) - Ministri i Infrastruktura, Arban Abrashi, ka nënshkruar memorandum për financimin e disa projekteve infrastrukturore në Komunën e Klinës, me nënkryetarin Besim Hoti.

Ministri Abrashi ka thënë se janë 33 projekte për vitin 2021 e që një pjesë e madhe e tyre janë me komunat e Kosovës, që do

të shërbejnë për përmirësimin e infrastrukturës. Ai ka pohuar se Klina është një nga komunat që përfiton katër projekte infrastrukturore, e që vlera e projekteve arrin afër një milion euro.

Në memorandum është ndërtimi i rrugës Klinë - Dresnik - Dollc, në vlerë prej 400 mijë eurove, ndërtimi i rrugës Ranoc - Leskoc -

Zllakuqan, në vlerë prej 250 mijë eurove, asfaltimi i rrugëve në fshatrat Jagodë, Budisalc dhe Bërvokë, në vlerë prej 60 mijë eurove dhe asfaltimi i rrugës Aqarevë - Siqevë, faza e dytë në vlerë prej 90 mijë eurove. Këto projekte do të ndahen me faza të financimit, e që janë në kuadër të marrëveshjeve të reja me komunat e Kosovës.



Tri raste të infektimit me variantin britanik të Covidit në Kosovë

Në Kosovë janë paraqitur tri raste të variantit britanik të Covid-19-shit. Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se situata me Covid në vendin tonë është e qetë. Ndërsa Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë pesë persona si pasojë e infektimit me Covid-19. Po ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur 342 raste të reja dhe janë shëruar 235 persona

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 JANAR (ER) - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije të premtën se tri mostra kanë rezultuar pozitive në variantin britanik të koronavirusit në Kosovë. Në një konferencë për media ai ka thënë se 30 mostra janë dërguar për analizim në një laborator në Gjermani. "Nga 35 mostra që i kemi dërguar, tri prej tyre kanë rezultuar pozitive", ka thënë Zemaj. Ndërsa Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë pesë persona si pasojë e

infektimit me Covid-19. Po ky institut ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur 342 raste të reja dhe janë shëruar 235 persona. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 926 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 342 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 5 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Deçan 1 rast (68 vjeç), Ferizaj 1 rast (75 vjeç), Gjilan 1 rast (64 vjeç), Mitrovicë 1 rast (69 vjeç) dhe Prishtinë 1 rast (64

vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 59 646 raste nga 229 408 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 1 487 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 235 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 51 948 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 211", ka njoftuar IKShPK-ja, duke bërë me dije se numri më i madh i rasteve të reja është në Prishtinë. "Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 85 raste, Prizren 41 raste, Mitrovicë 34 raste, Podujevë 30 raste, Suharekë 29 raste, Ferizaj 18 raste, Pejë 14 raste, Gjakovë 13 raste, Vushtrri 13 raste, Lipjan 11 raste, Fushë-Kosovë 10 raste,

Bëhet kategorizimi i komunave, në zonë të kuqe mbesin vetëm dy komuna

Ministria e Shëndetësisë ka bërë kategorizimin e ri të komunave sipas zonave, bazuar në numrin e rasteve brenda një jave në 100 mijë banorë brenda shtatë ditësh. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se Prishtina dhe Fushë-Kosova mbesin në zonë të kuqe, në të cilat lëvizja e qytetarëve është e lejuar deri në orën 21:30, ndërsa ndërprerja e lëvizjes zgjat deri në 5:00. Në zonën e verdhë janë 19 komuna: Podujeva, Mitrovica e Veriut, Mitrovica e Jugut, Zveçani, Gjilani, Suhareka, Lipjani, Obiliqi, Malisheva, Juniku, Vushtrria, Klina,

Shtimja, Prizreni, Peja, Gjakova, Graçanica, Kamenica, Ferizaj. Në zonën e gjelbër janë 17 komuna: Deçani, Vitia, Rahoveci, Dragashi, Drenasi, Istogu, Skenderaj, Leposaviqi, Kaçaniku, Klokoti, Zubin Potoku, Mamusha, Novobërda, Hani i Elezit, Parteshi, Ranillugu dhe Shtërpca. Në këto komuna operatorët ekonomikë e kanë të lejuar operimin deri në orën 22:00, ndërsa pas saj kësaj kohe shërbimin me vete. Po ashtu, nuk do të ketë pengesë për lëvizjen e qytetarëve. Ndryshe, në 24-orët e fundit në Kosovë janë konfirmuar 342 raste të reja me Covid-19.

Klinë 7 raste, Skenderaj 7 raste, Shtime 6 raste, Deçan 5 raste, Drenas 5 raste, Malishevë 4 raste, Dragash 2 raste, Gjilan 2 raste,

Istog 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë, Obiliq, Rahovec dhe Viti", ka njoftuar IKShPK-ja.



Mustafa diskuton në takim me zyrtarët e EPP-së për zhvillimet në Kosovë

PRISHTINË, 29 JANAR (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, dhe kandidati i kësaj parti për kryeministër, Avdullah Hoti, kanë zhvilluar një takim online me nënkryetarin e EPP-së, David McAllister dhe raportuesin e EPP-së për Kosovën, Daniel Braun, me të cilët ka diskutuar për gjendjen aktuale politike në vend dhe për qëndrimet e LDK-së karshi

kësaj situatë. Ai ka njoftuar delegacionin e EPP-së për zhvillimin e procesit të zgjedhjeve parlamentare në Kosovë dhe për punën e kandidatit tonë për kryeministër. "Gjatë këtij bashkëbisedimi u vlerësua se Hoti ka kryer një punë shumë të mirë dhe që disponimi i strukturave të LDK-së është shumë i mirë dhe çdo ditë po rritet më shumë", është thënë

në njoftimin e LDK-së. Sipas po këtij njoftimi, Mustafa u shpreh i përkushtuar për objektivat e LDK-së, përfshirë zhvillimin ekonomik, rritjen e punësimit, forcimin e ligjit dhe rendit dhe anëtarësimin e Kosovës në BE. Ndërkaq anëtarët e EPP-së shprehën urimet më të mira për kryeministrin Hoti dhe gatishmërinë për mbështetjen e tyre gjatë gjithë proceseve.



OAK-u kërkon eliminimin e barrierave të eksportit me Shqipërinë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 JANAR - Përfaqësues të Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) dhe të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në Shqipëri kanë diskutuar për eliminimin rreth barrierave për eksport me Shqipërinë. Po në këtë takim është diskutuar edhe për kërkesat e bizneseve prodhuese të produkteve ushqimore. “Në këtë takim theksuam se është e panevojshme të kërkohet raporti i analizës për produktet, në rastin kur produkti është i njëjtë, ndërkaq gjatë eksportit në vendet e tjera kërkohet vetëm certifikata e cilësisë. Pra, të mos ketë nevojë të bëhen analizat për të gjitha produktet, por që raporti i

analizës së njëjës të vlejë edhe për produktet e tjera me përbërje të njëjtë”, është thënë në komunikatën e OAK-ut. Me këtë rast, përfaqësuesit e OAK-ut kanë potencuar se sfidat me të cilat prodhuesit e produkteve ushqimore të Kosovës po përballen gjatë bashkëpunimit me Shqipërinë.

Gjatë këtij takimi drejtori i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës në Kosovë, Naser Krasniqi, ka thënë se barriera të tilla Kosova nuk aplikohen për bizneset nga Shqipëria. Sipas tij, është e rëndësishme që vendet tona t'i thjeshtësojnë sa më shumë procedurat dhe të krijojnë lehtësira gjatë bashkëpunimit.

Ambasadori i Kosovës në Shqipëri, Nait Hasani, ka thënë se është e domosdoshme që



marrëveshjet e nënshkuara në mes të Kosovës dhe Shqipërisë të ratifikohen në Kuvendin e Shqipërisë. “Në mënyrë që këto marrëveshje të zbatohen me përpikëri dhe të tejkalohen

burokracitë e panevojshme”, ka thënë Hasani.

Në këtë takim edhe zëdhënësi i AUV-it, Lamir Thaçi, ka shpalosur detaje të marrëveshjeve të nënshkuara në

mes të Kosovës dhe Shqipërisë e të cilat nuk po zbatohen në praktikë, duke theksuar që operatorët ekonomikë po hasin në vështirësi për shkak të këtij fakti.

Anashkalimi i sektorit të prodhimit nuk lejon zhvillimin ekonomik në vend

PRISHTINË, 29 JANAR - Sektori i prodhimit, i cili është një ndër shtyllat më me ndikim në ekonomi, përmes gjenerimit të vendeve të punës dhe përbushjes së kërkesës vendore, po përballlet me sfida të mëdha. Si rrjedhojë e natyrës së veprimtarive të këtij sektori të cilat nuk mund të kryhen nga distanca, masat mbrojtëse që kufizuan lëvizjen e lirë gjatë vitit 2020 nuk kanë lejuar zhvillimin e këtij sektori.

Gjatë forumit virtual të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, përfaqësuesit e kompanive prodhuese shpalosën përvojat e tyre, ballafaqimin me uljen e kërkesës në treg, vonesat për aprovimin e ndihmës financiare shtetërore dhe jostabilitetin politik gjatë periudhës së pandemisë. Të njëjtët diskutuan edhe mbi masat dhe politikat që duhet të zbatohen nga qeveria në ardhje, për ta siguruar rimëkëmbjen e këtij sektori dhe ekonomisë së Kosovës.

Lorik Fejzullahu, kryesues i



Bordit i Drejtorëve të kompanisë “Birra Peja”, njëherësh edhe anëtar i Bordit të Guvernatorëve të Odës Amerikane, foli për përmirësimin e marrëdhënieve tregtare me rajonin dhe proceset doganore. Fejzullahu adresoi edhe çështjen e dumpingut që vazhdon t'i dëmtojë prodhuesit vendorë, ndërsa me theks të veçantë rekomandoi dhe bëri thirrje që qeveria dhe institucionet shtetërore ta

shtojnë promovimin e produkteve vendore t'i krijojnë politikat e qarta për mbrojtjen e prodhuesve. Fejzullahu, gjithashtu, theksoi se për ta siguruar fuqizimin ekonomik dhe ndërveprimin mes bizneseve dhe politikës, duhet të krijohet një keshill ekonomik fiskal, i përbërë nga bizneset. Arbnore Musliu-Kunushefci, menaxhere e financave në kompaninë “Eurometal”, tha se

pandemia Covid-19 ka thelluar impaktin e problemeve ekzistuese në veprimtaritë e tyre prodhuese, veçanërisht për Tatimin e Vlerës së Shtuar (TVSh), që ndikon negativisht edhe në tërheqjen e investitorëve vendorë dhe të huaj. Më tutje, ajo potencoi se, pavarësisht prej këtyre sfidave, eksporti në shtete të tjera ka qenë burimi kryesor i të hyrave gjatë kësaj periudhe, ndërsa tha se ligjëbërësit vendorë

duhet t'i marrin parasysh edhe kompanitë e vogla, t'i profilizojnë nevojat e tyre dhe ta sigurojnë mbështetjen e nevojshme.

Pronari i “Elsa Group”, Brahim Selimaj, nënvizoi impaktin e sektorit të prodhimit në arkën shtetërore si dhe nevojën për fuqizimin e bashkëpunimit mes komunitetit të prodhuesve. Ai, gjithashtu, theksoi se procedurat dhe barrierat burokratike duhet të adresohen nga përfaqësuesit e sektorëve përkatës dhe ta kthejnë fokusin e shtetit në ekonomi dhe zhvillimin e saj. Më tutje, ai potencoi se bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Shqipërisë për marrëdhënie tregtare duhet të fuqizohet.

Teuta Kurshumlja, nga “Stone Castle”, njëherësh moderatore e forumit, tha se qeveria e ardhshme duhet ta trajtojë me seriozitet të veçantë sektorin e prodhimit dhe ta adresojë konkurrencën e padrejtë dhe çmimet e ulëta të produkteve të huaja në tregun shqiptar, që i bëjnë joatraktive produktet vendore.

Përfituesit e ndihmave sociale sot marrin dyfishin e asistencës sociale

PRISHTINË, 29 JANAR (ER) - Ministri në detyrë i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka njoftuar të gjitha familjet përfituese të asistencës sociale se sot (e shtunë) do ta pranojnë shumën e dyfishit të asistencës sociale ashtu siç është marrë vendimi për muajt janar, shkurt, mars 2021. “Njoftim për familjet përfituese të asistencës sociale.

Të gjitha familjet përfituese të asistencës sociale nga nesër do të pranojnë shumën e dyfishit të asistencës sociale ashtu siç është marrë vendimi për muajt janar, shkurt, mars 2021. Për shkak të interesimit të shumë familjeve, përfitues të asistencës sociale, dua të njoftoj se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka përcjellë listat e familjeve

përfituese në thesar, për të proceduar më tej për shpërndarje të pagesave që nga nesër nëpër të gjitha pikat postare në bazë të marrëveshjes së MPMS me Postën e Kosovës”, ka shkruar Reçica në profilin e vet në “Facebook”, duke shtuar se angazhimi ynë për t'u dalë në ndihmë kategorive në nevojë nuk do të mungojë asnjëherë.



Nitaj dhe drejtori i BERZh-it bisedojnë për avancimin e projekteve në fushën e energjisë dhe ndërmarrjeve publike

Drejtori i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) për Kosovë, Neil Taylor, ka deklaruar se është i gatshëm t'i çojë përpara projektet që janë në proces si dhe të ndihmojë në projekte të reja që ndërlidhen me fushën e energjisë dhe sektorë të tjerë që mbulon Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 JANAR - Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, Muharrem Nitaj, ka takuar drejtorin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) për Kosovë, Neil Taylor. "Temë diskutimi ishte bashkëpunimi në mes të Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) dhe BERZh-it në sektorin e ekonomisë, me theks të veçantë në atë të energjisë dhe të ndërmarrjeve publike. Nga fusha e energjisë është

diskutuar procesi i rishikimit të Strategjisë së Energjisë e, po ashtu, u bisedua për marrëveshjen e kredisë nga BERZh-i për infrastrukturën vitale që u dedikohet ndërmarrjeve publike", thuhet në njoftimin për media.

Nitaj ka konfirmuar gatishmërinë për bashkërendim të projekteve dhe interesave afatgjatë të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik si një nga faktorët kryesor për mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës. "Ju jemi mirënjohës për mbështetjen e deritanishme

që keni dhënë për avancimin e projekteve në fushën e energjisë, si dhe në atë të ndërmarrjeve publike, si sektorë të rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Andaj shpresoj që ky bashkëpunim i mirëqenë do të vazhdojë edhe në të ardhmen", ka deklaruar Nitaj.

Ndërsa drejtori i BERZh-it për

Kosovë, Neil Taylor, ka potencuar se është i gatshëm t'i çojë përpara projektet që janë në proces si dhe të ndihmojë në projekte të reja që ndërlidhen me fushën e energjisë dhe sektorë të tjerë që mbulon Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Marrëveshja e kredisë nga BERZh-i në vlerë prej 30 milionë eurosh ndahet

në dy transe. Transhi i parë kap vlerën 10 milionë, në të cilën përfshihet rimbursimi i shpenzimeve që veç ka përfunduar në kuadër të masës 4 të pakos emergjente, ndërsa vlera prej 20 milionë eurosh përfshihet në transhin 2, që duhet të shkojë si huazim nga Qeveria e Kosovës për ndërmarrjet publike.

Prezantohen rezultatet e auditimit për licencimin e shfrytëzimit të mineraleve ndërtimore dhe industriale

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 JANAR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka bërë prezantimin e raportit të performancës "Procesi i licencimit të shfrytëzuesve të mineraleve ndërtimore dhe industriale dhe mbrojtja e ambientit nga kjo veprimtari", në të cilin morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, Komuna e Malishevës, Komuna e Pejës, Institucioni i Avokatit të Popullit, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të mediave. Ndihmësauditörja e përgjithshme, Vlora Spanca, ka thënë se qëllimi i prezantimit publik të këtij raporti është që të nxisin një dialog kuptimplotë dhe efektiv me të gjitha palët e interesit lidhur me rezultatet e auditimit dhe se si rekomandimet e dhëna do t'i shërbejnë përmirësimit të procesit të licencimit të shfrytëzuesve të mineraleve ndërtimore dhe mbrojtjes së ambientit nga kjo veprimtari. Objektivi i këtij auditimi ka qenë vlerësimi i procesit të dhënies së licencave dhe lejeve për aktivitetet minerare. Rezultatet e auditimit kanë

treguar se institucionet përgjegjëse nuk kanë bërë mjaftueshëm për ta mbrojtur ambientin nga operatorët ekonomikë gjatë zhvillimit të aktivitetit mineral duke mundësuar që operatorët të operojnë pa zbatuar kriteret e kërkuara, pa ofruar siguri në terren dhe në disa raste duke vepruar ilegalisht.

Me qëllim të mbrojtjes së ambientit, ka nevojë për përmirësimin e sistemit të licencimit për shfrytëzim të mineraleve dhe aktiviteteve të veçanta si dhe për përmirësimin e sistemit për dhënie/monitorimin e pëlqimeve dhe lejeve mjedisore. Po ashtu, është i domosdoshëm përmirësimi i menaxhimit të inspektimeve për shfrytëzuesit e mineraleve dhe ngritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të nivelit qendror dhe lokal në fushën e mbrojtjes së ambientit.

Ky raport dhe rekomandimet duhet t'u shërbejnë ligjvënësve dhe atyre që janë përgjegjës për administrimin e parasë publike ta rrisin llogaridhënien në arritjen e objektivave strategjike lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe forcimin e sistemit të licencimit të operatorëve ekonomikë. Ndërsa udhëheqësi i ekipit që ka realizuar



këtë auditim, Labinot Sadiku, ka prezantuar gjetjet e auditimit dhe rekomandimet e dhëna për institucionet përkatëse duke nënvizuar që dhënia e licencave dhe lejeve nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit është përcjellë me mangësi. Këto kryesisht ndërlidhen me moskoordinimin me palët e tjera gjatë licencimit, mungesë të pëlqimeve nga organet përgjegjëse për rrugët, mungesë të programit të detajuar të rehabilitimit, vazhdim të

licencave në mungesë të rikultivimit të zonave ku janë shfrytëzuar mineralet. Me theks të veçantë duhet përmirësuar monitorimi i vlefshmërisë së pëlqimeve mjedisore dhe procesi i lejeve mjedisore, monitorimi i operuesve që shfrytëzojnë mineralet, inspektimi i shfrytëzuesve të mineraleve dhe të aplikohen dispozitat ndëshkuese. Me qëllim të adresimit të këtyre çështjeve të rëndësishme janë dhënë 17 rekomandime, kurse përfaqësuesit e institucioneve që ishin pjesë e procesit të auditimit

kanë shprehur gatishmërinë për t'i përgatitur planet e veprimit duke përcaktuar masat që do të ndërmerren, personat përgjegjës si dhe afatet kohore për zbatim të rekomandimeve.

Subjekte të auditimit kanë qenë Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, Inspektorati i Komunës së Pejës dhe Inspektorati i Komunës së Malishevës. Auditimi ka mbuluar periudhën e vitit 2019, ndërsa për qëllime krahasimore janë marrë vitet 2020-2018.

Kurteshi-Emini: Reshat Ymeri, simbol i sakrificës për lirinë e shqiptarëve

GJILAN, 29 JANAR (ER) - Në 31-vjetorin e vrasjes së dëshmorit Reshat Ymeri, nënkryetari i Gjilanit, Arbër Ismajli, me bashkëpunëtorë, dhe kryesuesja e Kuvendit Komunal, Shpresa Kurteshi-Emini, të premten kanë bërë homazhe te varrezat e dëshmorëve. Kryesuesja Kurteshi-Emini ka thënë se

Reshat Ymeri është simbol i sakrificës për lirinë e shqiptarëve. "Sot e kujtojmë dhe nderojmë veprën e tij të lavdishme për kauzën e përgjithshme kombëtare për çlirimin e vendit, për arritjen e lirisë dhe për rezultatet që ne i prekim sot, lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Gjilani në janar, përpos Reshat Ymerit,

ka dhënë shumë heronj, siç janë Kadri Zeka, Rexhep Mala e Nuh Berisha. Lavdi e përjetshme!", ka thënë Kurteshi Emini. Para 31 vjetësh, më 29 janar 1990, Reshat Ymeri (1962) u qëllua për vdekje nga policia serbe derisa po demonstronte kundër dhunës dhe padrejtësive të Beogradit mbi shqiptarët.



Prishe koalicioni LDK - LV në Vushtrri



VUSHTRRI, 29 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka zyrtarizuar të premten prishjen e koalicionit me Lëvizjen Vetëvendosje në komunën që ai udhëheq. Tahiri në një konferencë për media ka thënë se mosvotimi i planeve të rimëkëmbjes nga LV-ja është i papranueshëm. "Jemi komuna e parë që duam ta ndryshojmë agjendën e diskutimit në këtë vend. Mosvotimi i këtij plani nuk e ka asnjë kuptim. Kur

kemi hyrë në bashkëqeverisje kemi zotuar për një qasje ndryshe në qeverisjen komunale. Sukseset janë të padiskutueshme, dhe ne jemi ndër komunat me performancën më të mirë", ka thënë ai, duke shtuar se tani e tutje LDK-ja do të qeverisë e vetme në Vushtrri. "Nuk mund të lejoj që si kryetar komune një kryesi që merr një vendim politik për të mos përkrahur një plan për dalje nga kriza, të vazhdojmë të qëndrojmë në

bashkëqeverisje, prandaj kemi ardhur në këtë moment. Para tre vjetësh kam besuar te qytetarët e Vushtrrisë që do ta mirëkuptojnë, dhe njëjtë besoj edhe për këtë vendim. Ne do të qeverisim të vetëm, pa asnjë koalicion të ri. Vendimet do të shkojnë në Asamble Komunale dhe ato s'kanë të bëjnë me asnjë parti politike", ka thënë Tahiri. Kryetari Tahiri ka mohuar se arsye tjetër për prishjen e koalicionit janë zgjedhjet e 14 shkurtit.

Nis ndërtimi i QKMF-së në Mamushë

MAMUSHË, 29 JANAR (ER) - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka bërë me dije se të premten ka filluar ndërtimi i objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Komunën e Mamushës. Me këtë rast, Zemaj ka thënë se me ndërtimin e këtij objekti do të përmirësohet cilësia e shërbimeve shëndetësore në këtë komunë. "Sot filloi ndërtimi i objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mamushë, realizim i memorandumit të

nënshkruar kohë më parë, me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Presim aftësimin sa më të shpejtë të këtij objekti shumë të rëndësishëm shëndetësor për Mamushën dhe fshatrat përreth duke shtuar edhe hapësirat, personelin dhe pajisjet mjekësore. Komuniteti i kësaj ane ka kontribuar për fuqizimin e shtetësisë së Kosovës, zbatimin e barazisë e mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve në shtetin tonë. Urime!", ka thënë Zemaj.



Bulliqi takohet me taksistët që operojnë në Podujevë

PODUJEVË, 29 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, bashkë me anëtarët e ekzekutivit, ka mbajtur një takim me taksistët që operojnë në këtë komunë. Gjatë takimit të kryetarit Bulliqi me taksistët, ku ishin të pranishëm edhe drejtori i Inspeksionit, Ajet Potera, drejtori i Planifikimit Urban, Mbrojtjes dhe Mjedisit, Bujar Hasani, dhe drejtori i Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Fevzi Jetullahu, është biseduar për procedurat e pajisjes me leje të punës për

taksistët që nuk i posedojnë ato dhe organizimin më të mirë të punës së tyre, që ka të bëjë me vendqëndrimin-pikënisjen e tyre në qytet. Bulliqi ka thënë se pret një bashkëpunim të mirë me këtë kategori të transportuesve publikë me organet kompetente dhe në koordinim me drejtoritë përkatëse të caktohet pikënisja për taksitë. Ndërsa drejtori i Inspeksionit, Ajet Potera, është angazhuar që vendqëndrimet - pikënisjet, të cilat aktualisht shfrytëzohen nga taksitë pengojnë

qarkullimin në qytet. Prandaj, në bashkëpunim me vetë taksistët, do të gjendet një zgjidhje e favorshme, e cila do të jetë e favorshme për operimin e kësaj kategorie të transportuesve. Në anën tjetër, drejtori i Urbanizimit, Bujar Hasani dhe ai Shërbimeve Publike, Fevzi Jetullahu, janë shprehur të gatshëm për bashkëpunim dhe gjetjen e rrugëve ligjore për legalizimin e taksive të cilët nuk kanë leje pune dhe përcaktimin e pikënisjeve në qytet.



Aziz Kelmendi dhe enigma e vrasjeve pa luftë në kohë robërie (14)

Shqyrtimi kryesor vërtetoi se ishte gjykim i montuar politik




Lulzim SAHTI

Gjatë shqyrtimit kryesor pothuajse të gjithë të akuzuarit shqiptarë e kanë kundërshtuar dhe mohuar atë që kanë theksuar në hetuesi. Në këtë gjykim të montuar politik nuk u vërtetuan veprat për të cilat u ngarkuan të akuzuarit për, kinse, se Aziz Kelmendi u mor vesh më parë me ushtarët që akuzoheshin se i ndihmuan. Qysh në ditën e parë të gjyimit, më 11 janar 1988, i akuzuari Rizah Xhakli, në mbrojtjen e tij kundërshtoi në tërësi thëniet e aktakuzës, duke potencuar se asgjë nuk është e vërtetë, pos asaj që në fushën e basketbollit është takuar me Aziz Kelmendin dhe ushtarë të tjerë. Ndërkaq, Shefqet Paçarizi ka potencuar se nuk ka ditur çka ka planifikuar Aziz Kelmendi, ndërsa Abdylxhemil Alimani ka treguar se nuk ka bërë vepër penale edhe pse ka qenë në fushën e basketbollit nuk ka dëgjuar kurrfarë bisede rreth vrasjes së ushtarëve. Në ditën e dytë të gjyimit, më 12 janar, Afrim Mehmeti ka pranuar se me ushtarët e përmendur në aktakuzë ka qëndruar në fushën e basketbollit në rrethin e kazermës, mirëpo aty nuk ka pasur kurrfarë bisede të Aziz Kelmendit se do të vrasë Safet Dudakoviçin e Milorad Vukoviçin. Mandej Afrimi para trupit gjykues ka deklaruar troç se për përdorimin e pushkës automatike, Azizi nuk ka pasur nevojë të bënë kurrfarë ushtrimi "meqenëse sa kemi qenë bashkë ushtarë me të në një qytet tjetër (Leskovc), ai katër muaj ka qenë i angazhuar me pushkë automatike". Gjithashtu, Afrimi nuk ka pasur nevojë t'i tregojë Aziz Kelmendit se në dollapin në korridor të pavijonit ka municion, sepse pothuajse të gjithë ushtarët që shërbenin në këtë garnizon këtë e kanë ditur. Në vazhdim të kësaj seance gjyqësore, Pajazit Aliu ka thënë se nuk ka qenë në fushën e basketbollit, gjë të cilën e ka pohuar edhe Afrim Mehmeti. Në kohën kur Azizi ka zbratur rafalët, ai ka qenë fjetur bashkë me ushtarë të tjerë, tregon Pajazit Aliu. Nga dhuna e terrori i madh i ushtruar gjatë hetuesisë ndaj të akuzuarit Rizo Alibashiq për të deklaruar rrejtshëm kundër të akuzuarve shqiptarë, ai kishte rënë në depresion psikik dhe për një kohë ka

qëndruar për shërim në Klinikën Neuropsikiatrike të Spitalit Ushtarak të Nishit, u tha në ditën e tretë të gjyimit, më 13 janar 1988. Kjo më së miri tregon se në çfarë gjendje kanë qenë të akuzuarit tjerë gjatë kohës sa ishin në hetuesi. Megjithatë dhjetari Alibashiq para trupit gjykues e tha të vërtetën për municionin që ia kishte dhënë Azizit: "Para orës 3 të mëngjesit më zgjoi Azizi, i cili kishte pushkën me municion. Ia dhashë dy rrathë me nga 30 plumba. Për pushkën automatike nuk kisha më tepër municion. Ai më urdhëroi të shkoj me të në dhomën e fjetjes. Unë ecja përpara e ai pas meje, duke ma drejtuar pushkën në shpinë. U ktheva në pistë dhe atëherë dëgjova rafalët, kur edhe i dhashë rojës alarm", tregon rrjedhën e ngjarjes së asaj nate Alibashiq. Mirëpo deklarata e tij, ku inkuadronte posaçërisht Rizah Xhaklin ishte krejtësisht e pavërtetë, të cilën gjë sy më sy ia tha troç Xhakli, më 13 janar 1988 në sallën e Gjyimit. Ai ia përsëriti për të satën herë se më 2 shtator 1987 nuk ka ndejtur me Alibashiqin. Po në këtë seancë, ushtari Abdylxhemil Limani gjatë gjyimit ka treguar se organet e sigurimit kanë shfrytëzuar forcën gjatë kohës së hetuesisë për të detyruar atë në ndryshimin e deklaratës, gjë të cilën nuk e bëri asnjëherë. Ai nuk ka lëkundur qëndrimin e tij gjatë hetuesisë por as në shqyrtimin kryesor në Gjykatë. Kjo dëshmon se Alimani gjithnjë e tha vetëm të vërtetën duke treguar se nuk i ka premtuar kurrfarë ndihme Aziz Kelmendit, nuk ka sjellë pushkën në fushën e basketbollit dhe as që i ka dhënë karikatorin me fishekë. Me vet faktin që Azizi kishte në dispozicion 70 fishekë, prej të cilëve është dëshmuar se 26 janë shkrepur në dy dhoma dhe me një plumb është vetëvuarë, shtrohet pyetja çka i duhet municioni shtesë kur në realitet i ka pasur rezervë edhe 43 fishekë tjerë!?

Trillimi tjetër i prokurorit se "para se të zbrazë rafalët, Azizi tërhoqi nga dhomat të gjithë ushtarët e kombësisë shqiptare", gjatë shqyrtimit kryesor është dëshmuar se nuk është e vërtetë kjo akuzë ngase në dhomën nr. 41 ishin bashkërisht me Rizah Xhaklin dhe Islam Mahmutit edhe ushtarët e nacionaliteteve tjera: Petar Gjekiç, Nikola Vidoviç, Huso Kovaçoviç, Andrej Preshern, Mishko Zeliç, Goran Vidakoviç, Milorad Vukoviç, Stipe Miliç etj, kurse në dhomën nr. 42, krahas ushtarëve shqiptarë: Pajazit Aliut e Shefqet Paçarizit ishin në të njëjtën dhomë edhe ushtarët e



Aziz Kelmendi

komuniteteve tjera: Ante Jazhiç, Petar Popiç, Davor Staniç, Florijan Atanaso e të tjerë. Ndërkaq, dy ushtarë të kësaj dhome: Abdylxhemil Alimani dhe Shemsudin Selimoviç, në natën kritike ishin në roje prej orës 2:00 - 4:00, kurse në këtë kohë te porta e kazermës ishte ushtari Goran Kegel. Ndërkaq, në natën kritike, në përbërje të rojës ishin të vendosur në çadrën e rojës: Enver Behluli, rekrutë i dhomës 42, bashkë me ushtarët tjerë: Sebastijan Bexhedoviç, Shuçko Omeragiç, Ivica Shkoriç e Vladimir Milutinoviç, të cilët në atë kohë ishin duke fjetur. Në dhomën e tretë, numër 40, ku flinte edhe Aziz Kelmendi ishte vetëm një ushtar shqiptar, Afrim Mehmeti, pranë të cilit flinte Zoran Gjokiq dhe ushtarët tjerë: Zvonko Zatkovski, Branko Vujoviç, Zhelko Rokiç, Damir Mariç e të tjerë. Me një fjalë, kjo është krejtësisht absurde dhe pamundshme që Azizi të zgjonte nga gjumi ushtarët shqiptarë në dy dhomat e fjetjes dhe të mos i diktojë ata askush duke dalë nga dhomat! Në aktakuzën e fabrikuar gjithashtu përmendet se Sadik Kelmendi është dashur të vijë natën kritike nga Gjermania në Paraqin për të marrë Azizin dhe të ikë. Gjatë dëshmisë së tij, më 15 janar 1988, Sadiku, babai i Azizit tregoi: "Më 24 korrik të vitit 1987 jam kthyer nga vendlindja në Gjermani, ku isha në pushim mjekësor. Brenda kësaj periudhe (24 korrik - 1 shtator 1987) kam folur me telefon vetëm me anëtarët e familjes". Ndërkaq, me Azizin: "Kurrë nuk kam biseduar me telefon sa ka qenë ushtarë, e brenda kësaj periudhe as letër nuk i kemi shkruar njëri-tjetrit", tha Sadik Kelmendi para trupit gjykues. Kjo tregon më së miri se vizita e Sadikut dhe Salës atë mëngjes në Paraqin ishte e rëndomtë si herëve të tjera dhe

pa kurrfarë prapavije gjë që prokurori ushtarak nuk pati asnjë fakt për të akuzuar babanë e Azizit. Me një fjalë, të akuzuarit shqiptarë të vërtetën e thanë gjatë gjyimit, të cilës duhej t'i besohej e jo asaj çka kanë deklaruar gjatë hetuesisë ngase kanë qenë të shtrënguar nga gjykatësi hetues dhe nga pjesëtarët e sigurimit shtetëror. U vërtetua se të gjitha deklaratat e tyre gjatë hetuesisë janë dhënë nën presion e dhunë. Kjo ishte e dhënë plotësisht e saktë. Një gjë është e vërtetë se Azizi gjatë kryerjes së aksionit ka kursyer të gjithë bashkëkombësit e vet, madje në dhomën e tij nuk kishte shtënë fare. Po ashtu e vërtetë ishte se Azizi shoqërohej vetëm me shqiptar, gjë që të njëjtën gjë e bënin edhe ushtarët tjerë shqiptarë kudo që ishin në shërbim ushtarak. Domethënë, nuk kishte diçka risi në këtë aspekt. Nuk është e vërtetë që Azizi urrente popujt tjerë përpos atyre që përdornin aparatit shtetëror kundër popullit shqiptar.

Trupi gjykues, më 20 janar 1988, si dëshmi ka prezantuar fletoren e Aziz Kelmendit të gjetur më 5 shtator 1987, me rastin e kontrollimit të shtëpisë së prindërve të tij në Dushanovë. Në këtë fletore, Azizi kishte shkruar disa vargje, të cilat një pjesë e tyre ishin në formë të kujtimeve. Pothuajse në çdo vjershë të tij janë shkruar me germa të mëdha fjalët "Kosova Republikë". Ndër të tjera, në vargjet e tij thuhet:

"Në Prishtinë së pari u dha betimi dhe nga të gjitha anët në Kosovë si lumi u përhap "Kosova - Republikë"

"Më lindi ideja!

"Kjo është rruga e luftës".


"Rroftë Kosova - Republikë"

Më 25 janar 1988, në fjalën e tij përfundimtare prej 20 faqesh prokurori ushtarak, Zhivotije Bojiç për Azizin theksonte: "Ishte verbërisht përkrahës i idesë "Kosova - Republikë" dhe për atë se për realizimin e kësaj ideje duhet të zhvillohet luftë e

armatosur". Me këtë, Prokurori në fjalë, nuk ka zbuluar asgjë të re sepse në realitet është dëshmuar ajo siç ka menduar atëbotë Azizi.

Më 6 dhe 24 nëntor të vitit 1987 nga gjykatësi hetues ishte rikonstruktuar ngjarja e ndodhur ndërmjet 2 dhe 3 shtatorit të vitit 1987, në kazermën "Branko Krsmanoviç" në Paraqin. Para kamerave i kanë detyruar të akuzuarit e Procesit të Paraqinit t'i japin dëshmitë e tyre filmike dhe tonike se si gjoja kanë bërë marrëveshje te fusha e basketbollit dhe duke instruktuar rrejtshëm rolin e tyre në ngjarjen e zhvilluar brenda kazermës, ku u vranë katër ushtarë e u plagosën pesë të tjerë. Më 20 janar 1988, këto pamje filmike dhe tonike u prezantuan nga prokurori si dëshmi në gjykatë, mirëpo këtë rikonstruktim të montuar e hodhën poshtë të akuzuarit: Rizah Xhakli, Abdylxhemil Alimani, Afrim Mehmeti e Pajazit Aliu.

Në Gjykatën Ushtarake të Nishit, gjatë shqyrtimit kryesor, kryetari i trupit gjykues, koloneli Velko Miliç, duke parë aftësitë dhe zotësinë profesionale të avokatit Bajram Kelmendi, i kishte dhënë atij dy vërejtje me shkrim. Kjo bëhej me qëllim për ta frikësuar avokatin Kelmendi i cili gjatë zhvillimit të këtij procesi të montuar politik kishte arritur të çmontuar aktakuzën e konstruktuar nga KOS-i jugosllav. Ndërkaq, vajza e avokatit në fjalë, Kosovarija, në librin "Mbrojtësi" të gazetares Valbona Mehmeti kishte treguar: "Për sa kohë ka zgatur ai gjykim, unë çdo natë e kam pritur babanë te dritarja, afër pianos. Na ishte mbjell frika në familje se për shkak të mbrojtjes që ai e bënte, mund edhe të pësonte, pasi vazhdimisht ishte në përcjellje. Një herë, derisa kishte qenë në sallë të gjyimit, në gjykatoren e Nishit ia kishin shpuar të katër gomat e veturës...", rikujton Kosovarija, atëbotë 16 vjeçe. (Vijon)



Faksimile nga aktakuza e zgjeruar prej 167-faqesh në gjuhën serbokroate



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

NËSE ADEM DEMAÇI KA QENË KOMUNIST, VALON SYLA ËSHTË ABORIXHIN I AFGANISTANIT!

Koha e pishpirikëve, hip-hopit dhe patriotizmit jugosllav: Para shumë vjetëve, një politikan i profilit të lartë i PDK-së, që e kishte bërë një luftë të pastër çlirimtare, por që pas luftës e preferonte jetën si në serialet e Beverly Hillsit, çdoherë kur më takonte më thoshte: “Nëse asgjë nuk ke bërë në këtë jetë, atëherë të gjitha të falen shkaku se kurrë nuk iu ke ndarë Adem Demaçi, duke i ndenjtur gjithmonë afër...”. Pasi këto fjalë kaluan, më tepër në përpjekje të zhvendosjes së vëmendjes prej kritikave që ia bëja për sjelljet pas përfundimit të luftës, për ta ndërprerë këtë lloj komunikimi, iu përgjigja: “Po pse ju nuk po i qëndroni afër Bacës Adem Demaçi, përveç rasteve kur ju vjen veja te b...a apo kur keni nevojë për vota. Kush po jua ndalon. Pse e bëtë Pacollin president dhe nuk e bëtë Bacën Adem dhe shumë pse të tjera! Bacën Adem Demaçi, abetaren e luftës për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar sikur shumica e të rinjve të asaj kohe e kam njohur për kohën e gjatë, thua 30 vjet të kaluar nëpër kampet e përqendrimit të ish-Jugosllavisë e që i quanin burgje, shkaku i romanit ‘Gjarprinjtë e gjakut’, me një fjalë më shumë e përjetoja si mit, se një realitet jo i prekshëm apo i përjetuar. Në demonstratat e vitit 1968, kur isha “sa troha, por se vrapoja pas

demonstruesve tërë kohën në Prishtinë, pa e pasur një qëllim të qartë pse e bëja këtë, emri më i brohoritur ishte i Adem Demaçit, për të cilin nuk kisha informata përveç atyre që i përmenda më lart. Patriotët e viteve ‘60 në Llap, si i papërsëritshmi Xheladin Rekaliu, Elhame Shala-Bogujevci, Hamit Berberi, Hakif Sheholli, Ibrahim Durulaku, Qazim dhe Ibrahim Stublla dhe shumë të tjerë, që ose kishin mbajtur më herët, ose u arrestuan më vonë për organizim të demonstratave të vitit 1968, të gjitha i bënë në frymën e Bacës Adem Demaçi. Në atë kohë në Llap frymëzues për çdo veprim patriotik ishin Shaban Shala që vdiq nën torturë në burg duke kënduar se: “nuk është more këtu, as Serbi e as Jugosllavi, por është Shqipëri...” dhe Baca Adem Demaçi që e kishte botuar “Manifestin”, udhëzuesin dhe frymëzuesin për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar...”, “Gjarpërinjtë e gjakut” që qarkullonte duar në duar dhe të cilin, për herë të parë e kam parë, në disa vazhdimë në tavanin e shtëpisë sonë në Podujevë kur isha 10 vjeç, në revistën “Jeta e re”. Shtëpia e Shaban Shalës - Bajgorës, babushit tim, ishte e vetmja shtëpi shqiptare në atë kohë në qendër të qytetit të Podujevës e rrethuar me shtëpi të serbëve, 95

për qind e të cilëve ishin çetnikë të përбетuar. Nëse deri në vitin 1968 patriotizmi dhe sakrificat ishin shprehje e një rrethi të ngushtë me vetëdije dhe ndërgjegje kombëtare, pas vitit 1968, me rrëzimin e Rankoviçit dhe me një hapje, më vonë edhe me Shqipërinë, u rritë edhe vetëdija kombëtare. Atëherë mësuam se nuk është e jona Beteja e Kozarës, por Beteja në Fushën e Albulenës; mësuam se Mirko dhe Sllavko nuk janë heronj tanë, por se është Avni Rustemi, Bajo dhe Çerçiz Topulli; filluam të mësojmë se AVNOJ është festë e serbëve dhe jugosllavëve, kurse shpallja e Pavarësisë në Vlorë është festa jonë. E mësuam se flamuri me shqiponjën dykrenare është flamuri i vet qenies dhe ekzistimit të shqiptarëve, kurse trobojka e Jugosllavisë është flamur i jugosllavëve dhe shqipfolësve jugosllavë që na shtypnin më shumë se vet serbët dhe jugosllavët. Filluam të mësojmë se kryeqyteti ynë nuk është Beogradi, por është Tirana. E mësuam se himni ynë është: “Himni i Flamurit” e jo “Hej Slloveni...”. Në ngritjen e vetëdijes kombëtare ndikoi edhe diaspora që sillte literaturë nga jashtë si dhe profesorët dhe ligjëruesit që vinin në Kosovë, nga Shqipëria. Falë kësaj erdhi te ngritja e vetëdijes kombëtare, me

një dinamikë të shpejtuar. Prandaj erdhi viti 1974, 1979, 1981, 1989 dhe viti më i lavdishëm, jo për jugosllavët shqipfolës, por për patriotët e vërtetë shqiptarë, viti 1998 kur e lavdishmja Ushtri Çlirimtare e Kosovës e nisi dhe e përfundoi luftën çlirimtare.

Kur e takova apostullin e çështjes kombëtare, Bacën Adem Demaçi: Sikur që për çdo besimtar të besimit islam, vizita në vendet e shenjta, në Mekë dhe Medinë, sikur edhe vizita e varrit të Profetit Muhamed është detyrim dhe synim jetësor, sikur që për një besimtar të krishterë vizita në Vatikan dhe bekim nga Papa është synim i gjakuar, sikur që për një besimtar çifut vizita në Jerusalem, te Muri i Vajtimit apo vizita në Nazaret, apo aty ku qenka gozhdur Krishti është përmbushje e detyrimeve fetare dhe njerëzore apo për budistët vizita në Tibet dhe takimi me Dalaj Lamën që konsiderohet inkarnim i Budës, është arritja e nirvanës shpirtërore, fetare dhe njerëzore, edhe për çdo të burgosur politik shqiptar e që është patriot i vërtetë, takimi me Bacën Adem Demaçi është qëllimi dhe vendi ku hedhet spiranca kombëtare dhe patriotike. Në vitin 1981, pas një vizite të Xhevdet Hamzës në Sarajevë dhe takimit me autoritetet represive të Bosnjës

dhe Hercegovinës, si preventivë dhe për ta frikësuar komunitetin e madh shqiptar në Sarajevë, na dënuan tre shqiptarë; dy studentë dhe një punëtor krahu nga Kumanova. Mua më dënuan tre vjet burg, Hidajete Krasniqin nga Leshani i Pejës, studente, me dy vjet burg sikur edhe punëtorin nga Kumanova. Realisht, gjë prej gjëje nuk pata bërë përveç se flisja, kudo dhe kurdo për të drejtën e mohuar të shqiptarëve në Kosovë dhe Jugosllavi. Kam pasur shumë fat që në burg të Foçës takova Rexhep Malën dhe Skender Kastratin, që lindin një herë në 500 vjet e më vonë edhe Agim Sylejmanin.

Në vitin 1984, as edhe një vit pasi dola nga burgju, sa isha ushtar në ushtrinë jugosllave ku shkova pasi nuk doja të ikja jashtë vendit ndonëse, kudo që të shkoja, për 60 minuta do ta fitoja azilin politik, më arrestuan në kazermën e Iliriska Bisticës për të më dënuar me 12 vjet burgim në Gjykatën Ushtarake në Zagreb, pa bërë gjë prej gjëje, me një aktakuzë e ngjashme me këto të Gjykatës Speciale Raciste në Hagë. Jemi dënuar 9 ushtarë shqiptarë, kurse dëshmitarët kanë qenë 99 për qind shqiptarë sikurse hetuesi kryesor ka qenë një shqipfolës që pastaj ishte punësuar në institucionet e përkohshme të Kosovës. Kur

jemi arrestuar, komandant togu ka qenë Xhavit Kurtishaj, më kanë thënë se është kthyer në Kosovë, por se asnjëherë një fjalë nuk e ka nxjerrë nga goja për ta treguar të vërtetën. Nejse, kur më kanë dënuar 12 vjet burg mendimi i parë që më është sjellë në kokë ka qenë se: "Pasi jam i dënuar politikisht për herë të dytë, si recidivist e i papërmirësueshëm do të më dërgojnë në Kampin e Përqendrimit në Stara Gradishkë ku ishte Baca Adem Demaçi dhe shumë të burgosur të tjerë si: Fehmi Lladrovci, Hafir Shala, Haki Gashi, Tahir Hani, Zaim Beqiri, Bejtullah Ademi, Asllan Roshiti, Baca Zeqir Emini, Ismet Sopi (në Lepogllavë), Nuh Ahmeti, Adem Salihaj, Riza Demaj, Avdullah Dërguti, Halit Krasniqi, Hysen Shurdhani, Xhabir Morina Rrahim Rama dhe shumë të tjerë...". Me qenë në një burg me Bacën Adem Demaçi 12 vjet, jo që e merrja si dënim, por si arritje e madhe imja. Mirëpo, si ta dinin dëshirën time dhe më dërguan në Burgun e Lepogllavës e që për mua ishte një zhgënjim i madh. Të jem i sinqertë, sa kam qëndruar në Burgun e Lepogllavës, së paku 80 për qind të kohës e kam kaluar në vetmi e që e bëja me të vetmin qëllim të më transferojnë në Stara Gradishkë. Në mesvitin e vitit 1988, me një grup të të burgosurve politikë na dërguan në Burgun e Gospiqit ku na mbajtën të izoluar 13 muaj e pastaj, më në fund, më dërguan në Stara Gradishkë ku edhe e takova Bacën Adem Demaçi. Pra, për t'u takuar me Bacën Adem Demaçi kam bërë pesë vjet vetmi dhe izolim dhe afërsisht tre muaj grevë urie. Më duhet të them se në vitin 1981-1982 burgu i Gospiqit ishte vendi ku ishin torturuar në mënyrën më çnjerëzore të burgosurit politikë shqiptarë, duke i detyruar ta rrahin edhe njëri-tjetrin. Kjo për një kohë tjetër.

Gjatë qëndrimit me Bacën Adem Demaçi në Stara Gradishkë, afërsisht një vit mësova shumë gjëra që nuk i kisha mësuar në asnjë institucion arsimor. Baca Adem thoshte se vetëm liria nuk ka çmim dhe se kur është në pyetje liria, ia vlen në çdo kohë të jepet jeta. Gjithashtu, nuk kishte asnjë dilemë kur duhet përcaktuar midis përfundimit të jetës në mbrojtje të dinjitetit dhe jetës, qoftë edhe 200 vjeçe, pa dinjitet. Baca Adem thoshte se në luftë për liri duhet të bashkëpunoni me të gjithë, prandaj ai bashkëpunoi më vonë me Bakallin, Vllasin dhe Fadil Hoxhën, eksponentë të spikatur të politikës jugosllave dhe përndjekjes të patriotëve shqiptarë. Kjo qasje e Bacës Adem bëri që pas daljes nga burgu të shumicës së të burgosurve politikë shqiptarë në vitet '90, jo që nuk formuam parti politike, por e përkrahëm LDK-në dhe Ibrahim Rugovën. Të jem i sinqertë, asnjë i burgosur politik

shqiptar, gjatë vuajtjes së dënimit nuk kishte asnjë konsideratë për asnjë politikan shqiptar që tash ishin rreshtuar në LDK-së e që më parë kishin qenë pjesë e nomenklaturës politike jugosllave. Po të mos ishte maturia e Bacës Adem Demaçi, pasi dolëm nga burgu kishim disponim ta bënim skenën politike lëmsh dhe lesh sikur që nuk do t'i linim askund vend asnjë hetuesi, polici, prokurori apo gjykatësi që kishin përndjekur, torturuar, vranë dhe dënuar patriotë shqiptarë. Kështu, unë erdha në një pozitë jonormale, Gazmend Maliqi, udbashi gjakpirës ma kishte torturuar shoqen time, Fexhrije Bilallin-Shala një vit në burgun e Mitrovicës, si e burgosur politike kurse unë, me sugjerimin e Bacës bashkëpunojta me Shkëlzen Maliqin, vëllanë e Gazmendit. Kishte shumë raste të tilla që e bënim për ta krijuar një bashkim apo front politik dhe kombëtar pasi që bësheshim gati për luftë. Bacën Adem kam filluar ta njoh më afër në Burgun e Stara Gradishkës dhe nuk iu kam ndarë asnjëherë, deri në ditën kur ka ndërruar jetë dhe ka kaluar në amshim. Në Burgun e Stara Gradishkës kam qenë në gjendje ta bëj në qafë dhe të bëj çdo gjë për t'ia hequr disa detyrime por, në anën tjetër, kur është dashur të jap mendimin politik, nuk kam lëvizur aspak nga qëndrimi im, prandaj edhe më ka dashur sikur të më kishte vëlla. Gjatë qëndrimit në Stara Gradishkë jam bindur se Baca Adem nuk ka pasur as edhe një gram të vetëm bindje komuniste, por se ka qenë 100 për qind nacionalist shqiptar, që ka qenë në gjendje në çdo kohë të sakrifkohet për popullin shqiptar, por se nuk ka pasur aspak urrejtje ndaj asnjë populli në botë, madje as për popullin serb. E madhërisht! Disa të burgosur politikë shqiptarë që e lexonin Leninin, Marks, Engelsin apo Stalinin, Baca me të butë i këshillonte të mos humbin kohë me Leninin dhe Stalinin, por të lexojnë dhe studiojnë gjuhën dhe historinë shqiptare. Ishte plotësisht i vetëdijshëm se 99 për qind e të burgosurve shqiptarë nuk kishin kapacitet intelektual ta lexonin dhe kuptonin Karl Marks. Kurrë dhe në asnjë rast nuk e kam dëgjuar Bacën duke dëgjuar apo kënduar këngë për Titon apo Enverin, por ka kënduar për Dedë Gjo Lulin apo Çerçiz Topullin. Madje, në shumë biseda Baca thoshte se gjatë varrimit do të kishte dëshirë t'i këndohej kënga e Dedë Gjo Lulit për dallim të disa analistëve të sotëm dhe prindërve të tyre që e kanë kënduar: "Druzhe Tito, mi ti se kunemo=Shoku Tito, ne të betohemi...". Në kohën tonë ishin dy mundësi, ose të mbijetosh dhe të përparosh duke i kënduar Titos dhe Rrahman Morinës, ose të burgosesh dhe të dënohesh si përkrahës i Enver Hoxhës?! Midis Titos dhe Enverit, për një

patriot shqiptar nuk kishte fare mëdyshje, ishin për Enver Hoxhën sepse ishte udhëheqës i Shqipërisë. Edhe mua, kur më kanë dënuar në dy raste me 3 dhe 12 vjet burg, më kanë bërë më enverist se vetë Ramiz Alia, ndonëse për Enver Hoxhën kurrë nuk e kam çarë trapin. Madje çdo i burgosur që ka qenë me mua në burg edhe vetëm 5 minuta, është bindur se nuk kam asgjë të përbashkët me Enver Hoxhën, jo të PDK-së, por të Shqipërisë. As Baca Adem nuk ka pasur asnjë konsideratë për Enver Hoxhën, gjë që e ka bërë publike pas vizitës së parë në Shqipëri. Gjatë qëndrimit në Stara Gradishkë, Baca Adem më ka treguar për shumë intelektualë kosovarë që kanë qenë dëshmitarë kundër tij e që deri vonë kanë zënë vende të rëndësishme në hierarkinë politike dhe intelektuale të Kosovës e që kanë qenë mjeranë të vërtetë, spiunë të ulët. Të tillë i kanë edhe fëmijët sot e që, një pjesë e tyre po merren me vlerësimin e personalitetit të Adem Demaçit. Adem Demaçi kurrë nuk e ka nënçmuar apo fyer Rugovën, por ka bërë përpjekje të marrë përgjegjësi në luftë për liri dhe çlirim. Ibrahim Rugova, jo se nuk e ka dashur lirinë, por nuk ka qenë në gjendje ta bëjë as sakrificën më të vogël për liri, personale dhe familjare. Sa për Ibrahim Rugovën, kurrë në Kosovë nuk do të kishte luftë dhe rrjedhimisht as liri dhe çlirim. Ky ka qenë dimensionin me të cilin nuk është pajtuar Baca Adem me Ibrahim Rugovën. Shumë më keq janë sjellë me Ibrahim Rugovën disa zyrtarë të lartë të LDK-së se Baca Adem. Ata janë gjallë, edhe unë jam gjallë dhe i kam faktet. E keqja është se Baca Adem, për disa gjëra më ka thënë të mos i bëj publike tash, por t'i lë të shkruara. Atë edhe jam duke e bërë. Pas daljes nga burgu, me të mësuar se Baca Adem nuk e ka mendjen të formojë parti politike, shumë karrieristë janë larguar nga Baca dhe ka mbetur një rreth i ngushtë që nuk iu është ndarë Bacës, në asnjë rrethanë. Para lufte Baca Adem është shoqëruar me Rexhep Ukën e sidomos me Ahmet Haxhiun (gjyshin e Albulenës) për të cilin ka pasur respekt dhe dashuri vëllazërore, deri në kohën kur ka vdekur. E ka pasur mik Muamer Gjinollin, kurse vazhdimisht e ka vizituar Rexhep Abejen (Avdullahun) dhe Pashkë Stakën të NDSH-së. Derën, 24 orë e ka pasur të hapur të Shashivar Makolli, Nuh Ahmeti, Avdullah Dërguti dhe tek unë, Behxhet Sh. Shala. Realisht, ne i kemi ndenjtur afër deri në vdekje, pa iu ndarë as edhe një ditë të vetme për dallim nga disa të tjerë që, pasi u sëmure e kanë vizituar, 1 herë në 12 muaj. Në Maqedoni, Tahir Hani ka qenë strehë dhe përkrahje e përhershme, pa kursyer asgjë për Bacën Adem. Hetem Ramadni dhe Fatmir Zymberi e kanë përkrahur çdoherë Bacën, ndonëse Baca ka qenë shumë

modest në shpenzimet që i ka bërë. Paratë kryesisht i ka dhënë për shokët e burgut, me gjendje të vështirë materiale dhe familjet që kanë humbur anëtarë të familjes. Respekt të veçantë Baca Adem ka pasur për Rexhep Malën, Hasan Malën, Hanife Malën, Fitore Malën që i ka vizituar shpesh. Për Fehmi dhe Xhevë Lladrovcin ka pasur dashuri të veçantë si edhe për dr. Hafir Shalën. Ilmi Reçica në Ferizaj dhe Prishtinë, dr. Haki Gashi në Therandë kanë qenë shokë të pazëvendësueshëm. Vlerësim të jashtëzakonshëm ka pasur, deri në kohën kur ka ndërruar jetë për Kadri Veselin dhe Adem Jasharin. Sejdi Gega në Gjermani dhe Hysen Shurdhani në Zvicër kanë bërë shumë për Bacën. Pas përfundimit të luftës, investimin më të madh politik Baca Adem e ka bërë në Albin Kurtin. Pa Adem Demaçin dhe përkrahjen e të tjerëve, Albin Kurti nuk do të ishte ky që është. Mirëpo, madhështia e Bacës Adem është se e ka gjetur kohën kur është tërhequr nga Albin Kurti. Për këtë sigurisht do të shkruaj më vonë për faktin se kam aq shumë informata sa që do të ishte mëkat të mos bëhen publike. Baca Adem ka qenë personi më i sulmuar në Kosovë nga ish-titistët, por edhe më i nëpërkëmburi, nga ish ata që janë shitur si shokë të tij! Kur Bleron Baraliu propozoi që Baca Adem të zgjidhet president i Kosovës i patëm dy pole, e kundërshtuan dhe nuk pranuan ata që do të duhej të ishin përkrahës më të mëdhenj dhe të pakundërshtueshëm, PDK dhe LV kurse, në këtë aspekt 100 mijë herë kanë qenë më korrekt Isa Mustafa i LDK-së dhe Daut Haradinaj i AAK-së. Edhe për këtë kam shumë argumente të cilat i dinë edhe Albini, edhe Shimi, edhe Isa sikur edhe Dauti. Në çastin kur midis Pacollit dhe Adem Demaçit, mendermethënë klasa politike e Kosovës u përcaktua për Pacollin, e prekëm fundin e ndryshkut moral dhe njerëzor, prandaj zhvillimet e mëvonshme, sikur edhe këto të sotëm, nuk kanë mundur të jenë tjera!

Baca Adem, njeri i madh dhe shqiptar i madh dhe asnjëherë komunist: Adem Demaçi është njeri që lind një herë në një mijë vjet, ndoshta edhe më rrallë. Është njeri që çdo gjë e ka dhënë për njerëzimin dhe shqiptarët, është respektuar nga njerëzimi dhe është përbuzur nga mendermethënë shqiptarët. Adem Demaçi ka qenë autoritet moral dhe ka pasur autoritet moral, kurrë nuk ka synuar të bëhet autoritet politik, në kundërshtim me vlerat morale dhe kurrë nuk ka pasur pushtet politik. E vërteta është se gjithmonë e kanë penguar, pikërisht ata që e kanë pasur detyrim ta përkrahin. Në kohën kur ndryshku moral është bërë lëkurë dhe veshje e përditshme e një grumbulli horrash, është e natyrshme që nuk vlerësohet figura, personaliteti, vepra dhe

jeta e Adem Demaçit, madje bëhen përpjekje për denigrim të Adem Demaçit. Adem Demaçi nuk ka qenë urreyes i askujt, as nuk ka punuar për të keqen e askujt por, Adem Demaçi ka falur shumë, madje edhe ato që nuk falen. Me Adem Demaçin nuk ka mundur të manipulohet as Jugosllavia, as Serbia, nuk ka mundur ta blejnë me asgjë dhe disa injorantë sot e thonë të kundërtën duke e injoruar faktin se për interes të Kombit dhe të Shtetit, Adem Demaçi është shndërruar edhe në tepih mbi të cilin kanë shkelur garda e pandershme e horrave. Këtu qëndron madhështia e Adem Demaçit të cilin nuk e ka asnjëri nga ne që jemi kalimtarë të rastit në këtë botë! Dikush e sulmon Sali Berishën se ia paska prerë thonjtë Enver Hoxhës dhe e akuzojnë për këtë. Në kohën kur Baca Adem ka qenë sëmure, unë ia kam prerë thonjtë 100 herë, çdoherë kur është dashur dhe nuk ka pasur shërbim që nuk kam qenë në gjendje ta bëj dhe përsëri më duket se nuk kam bërë asgjë, se i kam mbetur borxh një personaliteti që çdo gjë e ka dhënë për lirinë e popullit e që disa nuk e meritojnë sepse e duan një liri tjetër, lirinë e kohës së Jugosllavisë dhe Serbisë. Çështja e vlerësimit të personalitetit dhe ndërtimit të një tregimi për personalitete apo procese historike i krahasoj me çështjen e kontabilitetit; mashtruesit, për të fituar sa më shumë dhe sa më pandershëm udhëheqin kontabilitet të dyfishtë, njërin për mashtrimet e veta e tjetrin për autoritetet tatimore. Kështu pati bërë edhe Al Kapone, por pikërisht kontabiliteti dhe kontabilistët ia hëngrën kokën. Edhe këta përfituesit e çastit dhe të rastit në Kosovë po veprojnë pikërisht si Al Kapone, po përpiqen ta zhvleftësojnë Adem Demaçin dhe, në të njëjtën kohë, t'i mbivlerësojnë antivlerat apo ndryshkun moral dhe njerëzor, për një grusht parash. Adem Demaçi, Adem Jashari dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës janë vlera dhe vepra të përjetshme që e tejkalojnë çdo kohë dhe çdo interes politik. Sa më shumë përpiqeni t'i ngulfatni dhe t'i guani në harresë, bëhen edhe më të mëdha. Por jo në kohën e horrave dhe të ndryshkut moral dhe njerëzor. Figurat madhështore dhe veprat madhështore në asnjë vend të botës nuk janë vlerësuar për së gjalli të atyre që kanë krijuar vepra, por është dashur të kalojë një kohë kur është bërë vlerësimi i drejtë. Sot, për Adem Demaçin, flasin më së paku ata që e njohin Bacën sepse ia kanë shitur shpirtin djallit për një interes politik a material e më shumë flasin horrat për të cilët nuk më mbetet aspak hatri për faktin se të parët janë horra më të mëdhenj se këta horrat-morrat, me prejardhje politike jugosllave. Janë si Ali Pashë Tepelena, trupin në Kosovë, kokën në Serbi!



SHPALLJE PËR VEND TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Zyrtar i lartë i protokollit
Njësia : Kabineti i Guvernatorit
Niveli i gradës: 5
Raporton tek: Guvernatori

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Bën planifikimin, zhvillimin, menaxhimin dhe ekzekutimin e ngjarjeve kryesore të organizuara nga BQK-ja;
- Në pozitën e Zyrtarit të lartë të protokollit të BQK-së, siguron që protokollin të kuptohen dhe zbatohen në të gjitha takimet dhe ngjarjet e BQK-së;
- Zhvillon dhe zbaton politika, strategji, udhëzime dhe procedura në lidhje me menaxhimin protokollit të BQK-së;
- Jep këshilla për politikën profesionale për protokollin, ngjarjet dhe çështjet e logjistikës;
- Siguron udhëzime për stafin e lartë, përfshirë Guvernatorin, për vizita të nivelit të lartë dhe zyrtar, përfshirë zhvillimin e programit dhe protokollin e ngjarjeve;
- Ofron këshilla për çështjet e protokollit, përfshirë praktikën dhe procedurat e BQK-së dhe ndihmon në sigurimin e administrimit të saktë të pjesëmarrjes në takime dhe ngjarje nga personalitetet e nivelit të lartë;
- Koordinohet me akterët kryesorë për të lehtësuar aranzhimet e mbërritjes dhe largimit për vizitat dhe personalitetet e nivelit të lartë;
- Përveç efikas në cilësi, angazhohet në shtim të efikasitetit të punëve të fushës përkatëse duke aplikuar iniciativë të reja për ngjarjet dhe menaxhimin e protokollit;
- Planifikon vizita, ceremoni dhe ngjarje të veçanta të huaja dhe të brendshme;
- Bën përpilimin dhe dërgimin e ftesave;
- Krijon aranzhime të përshtatshme për ulëset;
- Merr pjesë aktive në organizimin e konferencave të shtypit dhe organizon mundësi fotografimi dhe marrje të pamjeve për mediat gjatë ngjarjeve dhe është bartës i protokollit gjatë konferencave;
- Zhvillon itinerare dhe agjenda;
- Organizon akomodime për strehim dhe takime.
- Parandalon shkeljet e kodit të mirësjelljes ose gabimeve ceremoniale dhe kulturore.
- Mban një listë të drejtuesve kryesorë të bankave qendrore dhe zyrtarëve qeveritarë.
- Kryen detyra të tjera të kërkuara nga Guvernatori apo personeli i caktuar nga Guvernatori.

Njohurit e kërkuara:

- Diplomë universitare nga fusha e ekonomisë, juridikut ose menaxhimi i biznesit;
- Aftësi të mira ndërpersonale;
- Aftësi të mira komunikimi verbal dhe në të shkruar;
- Njohuri të shkëlqyeshme të aplikacioneve të MS Office;
- Njohja e gjuhës angleze.

Përvoja e kërkuar:

- Së paku pesë vite përvojë pune në lëmin e protokollit;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust apo ATK;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **15 shkurt 2021**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**



OGLAS O SLOBODNOM RADNOM MESTU

Naslov: Viši službenik protokola
Odeljenje: Kabinet guvernera
Stepen: 5
Izveštava kod: Guvernera

Sažetak dužnosti i odgovornosti:

- Planira, razvija, upravlja i izvršava ključne događaje koje organizuje CBK;
- Na položaju Višeg službenika za protokol CBK-a, osigurava da se protokoli razumeju i primenjuju na svim sastancima i događajima CBK-a;
- Razvija i sprovodi politike, strategije, uputstva i procedure u vezi sa upravljanjem Protokolom CBK-a;
- Daje savete o stručnim politikama u vezi sa protokolom, događajima i pitanjima logistike;
- Osigurava uputstva za više osoblje, uključujući guvernera, o posetama na visokom nivou i službenim posetama, uključujući razvoj programa i protokole događaja;
- Pružna savete o pitanjima protokola, uključujući prakse i procedure CBK-a, i pomaže u osiguravanju tačne administracije prisustva na sastancima i događajima od strane ličnosti visokog nivoa;
- Koordinira sa glavnim akterima radi olakšavanja aranžmana dolaska i odlaska za posete i ličnosti visokog nivoa;
- Pored efikasnosti u kvalitetu, bavi se i povećanjem efikasnosti rada na odgovarajućem polju primenom inovativnih inicijativa za događaje i upravljanje protokolom;
- Planira posebne strane i unutrašnje posete, ceremonije i događaje;
- Sastavlja i šalje pozivnice;
- Stvara odgovarajuće aranžmane za sedišta;
- Aktivno učestvuje u organizaciji konferencija za štampu i organizuje mogućnosti fotografisanja i uzimanja kadrova za medije tokom događaja i nosilac je protokola tokom Konferencija;
- Izrađuje itinerare i agende;
- Organizuje akomodaciju za smeštaj i sastanke.
- Sprečava kršenje kodeksa ponašanja ili ceremonijalnih i kulturnih grešaka
- Održava listu glavnih rukovodilaca Centralne banke i vladinih službenika.
- Obavlja druge dužnosti koje zahteva guverner ili osoblje koje odredi guverner.

Potrebna znanja:

- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, prava ili upravljanja biznisom;
- Dobre međusobne sposobnosti;
- Dobre verbalne i pisane sposobnosti komunikacije;
- Odlično poznavanje aplikacija MS Office;
- Poznavanje engleskog jezika.

Potrebno iskustvo:

- Najmanje pet godina radnog iskustva u oblasti protokola;

Svi kandidati moraju poslati sledeće dokumente:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno pismo (motivaciono) u kome se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od nadležne institucije/organizacije potkrepljen dokazima Trust-a ili PAK-a;
- Kopije diploma. Diplome stečene izvan Republike Kosovo MONT mora službeno da ih prizna/nostrifikuje;
- Dokazi o identitetu i stalnom prebivalištu na Kosovu.

Procedura apliciranja:

- Posljednji rod za apliciranje je **15. februar 2021. godine**.
- Apliciranje se može izvršiti online (<https://hris.bqk-kos.org>) putem službene internet stranice CBK-a ili putem arhive CBK-a, br:8. Nijedan drugi oblik apliciranja neće biti uzet u obzir.
- Obrazac za aplikaciju možete preuzeti putem službene interne stranice : www.bqk-kos.org
- Nepotpuna dokumentacija se neće uzeti u obzir.**



Data: 30.01.2021

Kryeshefi Ekzekutiv në bazë të nenit 17 paragrafi 3, pika 1 e Statutit të HK-Trainkos-SH.A nr. 1/188, të datës 05.10.2015, në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 si dhe në bazë të nenit 4 të UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MPMS) NR. 07/2017, shpall:

K O N K U R S

Titulli i pozitës së punës: Mekanik i Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse

Institucioni: Hekurudhat e Kosovës-Trainkos- SH.A.

Tipi i Akt Emërimit të punës: I plotë

Titulli i mbikëqyrësit: Menaxheri i Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse

Kohëzgjatja e kontratës: 1 vit

Procedura e aplikimit: I jashtëm

Vende të lira punë: 2 pozita (vende pune)

Vendi: Fushë Kosovë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen punët në mënyrë kualitative si dhe sipas normave teknike nga lëmia e tij profesionale;
- Punët e tij i vërteton me shkrim;
- Kujdeset për shfrytëzimin sa më racional të materialit;
- Pastron veglat e punës dhe vendin e tij të punës;
- Duhet t'ju përbahet rregullave të punës dhe sigurisë gjatë punës;
- Të konsultohet gjithnjë me kryepunëtorin lidhur me problemet e paraqitura gjatë mirëmbajtjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së Shefit të Njesisë në koordinim me Menaxherin e Sektorit;
- I përgjigjet Shefit të Njesisë.

Kushtet dhe kriteret, kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathësitë e tjera:

- Te ketë te kryer Shkollën e Mesme Drejtimi Mekanik
- Të dëshmojë Certifikatën Mjekësore që është i aftë për punë (certifikatën duhet ta sjell para se te nënshkruhet kontrata e punës)
- Të ketë të bashkangjitur edhe CV-në personale.
- Të jetë i aftë të punoj nën presion
- Preferohet të ketë përvojë pune në këtë lëmi.

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar Ligjor

Institucioni: Hekurudhat e Kosovës -Trainkos-SH.A.

Tipi i Akt Emërimit të punës: I plotë

Titulli i mbikëqyrësit: Udhëheqës i Zyrës Ligjore

Kohëzgjatja e kontratës: 1 vit

Procedura e aplikimit: I Jashtëm

Vende të lira punë: 1 pozitë (vend pune)

Vendi: Fushë Kosovë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Asiston në përpilimin e Rregulloreve dhe akteve tjera të Ndërmarrjes
- Përfaqëson dhe përgatitë të gjitha shkresat, parashtresat për Ndërmarrjen në të gjitha proceset gjyqësore duke i respektuar të gjitha afatet ligjore;
- Me kërkesë të Udhëheqësit përgatitë vendime, shkresa, parashtresa tjera për Ndërmarrjen;
- Interpreton dhe mban përgjegjësi për të gjitha interpretimet ligjore që kërkohen nga personeli i Ndërmarrjes;
- Në bazë të nevojave të Ndërmarrjes jep këshilla ligjore, harton kontrata, marrëveshje dhe memorandume për nevoja të Ndërmarrjes;
- Cakton ekspertiza, superekspertiza për nxjerrjen e provave me qëllim të mbrojtjes sa më efikase të Ndërmarrjes;
- Siguron provat elementare nga Sektoret përkatëse në rastet e ngritjes së padive nga Ndërmarrja;
- Përgatitë propozime për ekzekutime në të gjitha rastet e aktgjyqësive të formës së prerë;
- Kryen edhe detyra tjera të caktuara nga Udhëheqësi i Zyrës;
- Për punët e kryera harton raporte të rregullta dhe periodike;
- Për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë i përgjigjet Udhëheqësit të Zyrës.

Kushtet dhe kriteret, kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathësitë e tjera:

- Te ketë Shkollim Universitar – Fakulteti Juridik
- Të ketë të bashkangjitur edhe CV-në personale
- Të jetë i sjellshëm dhe komunikativ
- Të jetë i aftë të punoj nën presion
- Preferohet të ketë përvojë pune në këtë lëmi.

Aplikacioni dhe konkursi mund të merret në ndërtesën e Drejtorisë në Fushë Kosovë apo në www.trainkos.com. Aplikacioni së bashku me dëshmitë të dorëzohen në ndërtesën e Drejtorisë së HK-Trainkos-SH.A. në adresën "Sheshi i Lirisë" nr. 22, në Fushë Kosovë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur, në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: **13.02.2020 ora 16:00**. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk iu kthehen. Vetëm kandidatet e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "SWISS ENGINEERING" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810081612, Skënderaj, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "SWISS ENGINEERING" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 810081612, Skënderaj ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "SWISS ENGINEERING" L.L.C. has come to the decision to quit its nr: 810081612, Skënderaj the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Fatijon Rexhaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Dëshmorët e Kabashit " Korishë.

► Alban Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Luigj Gurakuqi " Nashec.

► Ramush Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Sanel Duraku shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

► Aida Ilijazi shpall të pavlefshme dy dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Doruntina Zogiani shpall të humbur diplomën e Fakultetit të FSHMN-së drejtimi Fizikë -arsimore, në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", data e lëshimit diplomës 12 shkurt 2007.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kiesłowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kiesłowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kiesłowski, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kiesłowski dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti


AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚŁOWSKI

AGRON SHALA

DEKALOGU

『nga Moisiu deri te Kiesłowski』

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

